

## RAPORT


### I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Për Programin e studimit Master i Shkencave në  
“Komunikim - Marrëdhënie publike” me profile:**

- a) Studimet dhe teoritë e komunikimit;**
- b) Marrëdhënie publike**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof As. Ilir Yzeiraj
2. Dr. Arben Muka



(Prill, 2018)

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për programin e Studimit Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie publike”, me profile: a. Studimet dhe teoritë e komunikimit;**  
**b. Marrëdhënie publike**

<b>Tabela e të dhënave për programin e studimit</b>		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr.74, datë 21.01.2009
4	VKA / Urdhëri i Akreditimit të parë	VKA, Nr. 133, datë 21.12.2010/ UMASH Nr. 68, datë 14.02.2011
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie publike” me profile: a. Studimet dhe teoritë e komunikimit; b. Marrëdhënie publike
6	Cikli i studimit:	Cikli II
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Nga UET
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
13	Diplomë e përbashkët Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin)	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2009
16	Numri total i studentëve për program studimi	
	2011-2012	a. Studimet dhe teoritë e komunikimit 7 studentë b. Marrëdhënie publike 19 studentë
	2012-2013	a. Studimet dhe teoritë e komunikimit 2 studentë b. Marrëdhënie publike 21 studentë
	2013-2014	a. Studimet dhe teoritë e komunikimit 1 studentë b. Marrëdhënie publike 22 studentë
	2014-2015	a. Studimet dhe teoritë e komunikimit 1 studentë b. Marrëdhënie publike 23 studentë
	2015-2016	a. Studimet dhe teoritë e komunikimit 0 studentë b. Marrëdhënie publike 33 studentë
	2016-2017	a. Studimet dhe teoritë e komunikimit 0 studentë b. Marrëdhënie publike 21 studentë
	2017-2018	a. Studimet dhe teoritë e komunikimit 0 studentë b. Marrëdhënie publike 21 studentë

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

## HYRJE

### **Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike”, me profile: a) Studimet dhe teoritë e komunikimit; b) Marrëdhënie publike**

Programi Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike” me dy profile: a. Studime dhe Teoritë e Komunikimit; b. Marrëdhënie Publike është akredituar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 68, datë 14.02.2011.

Ky program është në Departamentin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, si një nga tre departamentet e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit në Universitetin Europian të Tiranës, UET.

Masteri i shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike” me dy profile: a. Studime dhe Teoritë e Komunikimit; b. Marrëdhënie Publike, ka për qëllim aftësimin e studentëve në studimin e thelluar të teorive dhe modeleve bashkëkohore të komunikimit, të ndara sipas disa prej fushave kryesore të zbatimit të tyre në politikë, në shoqërinë civile, biznes etj., si dhe të përgatisë ekspertë komunikimi të aftë për t'u angazhuar në menaxhimin e marrëdhënieve publike në sektorë të ndryshëm. Përmes profilit “Marrëdhënie Publike” UET synon përgatitjen e ekspertëve të komunikimit politik dhe organizativ, të aftë për të punuar në departamentet e medias të institucioneve publike dhe private; kurse në profilin tjetër “Studime dhe Teoritë e Komunikimit” në fokus të kurrikulës është studimi i thelluar në teoritë e aplikuara të komunikimit, aftësimin e ndjekësve të programit në analiza semiotike dhe ligjërimore të fenomeneve sociale dhe politike.

Ky vlerësim i ekspertëve të jashtëm për Programin Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike” me dy profile: a. Studime dhe Teoritë e Komunikimit, u realizua në kuadër të procesit të riakreditimit, duke u bazuar:

- në shqyrtimin e e të gjithë dokumentacionit përkatës,
- nga gjetjet dhe informacioni i mbledhur në vizitën dyditëshe që u zhvillua në UET, fakultetin dhe në departamentin që mbulon zhvillimin e Programit që akreditohet,
- nga prezantimi që ka bërë IAL-ja në raportin e vlerësimit të brendshëm.

## **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ:

1. Prof As. Ilir Yzeiraj
2. Dr. Arben Muka

Menaxher teknik i ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure: Renata Qatipi (specialiste në ASCAL).

Më datë 20.04.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 25/24 Prot., datë 23.04.2018 me lëndë “Dërgohet Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm”, UET është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 30.04.2018, UET përcjell nëpërmjet sistemit AMS në ASCAL “Disa komente, sqarime dhe plotësime në lidhje me draft raportin e hartuar nga GVJ”, ndërsa me shkresë Nr. 10/17 Prot., “Dërgohen komentet në lidhje me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm” ato sillen zyrtarisht.

GVJ pasi lexoi me kujdes komentet e IAL vendosi të marrë në konsideratë komentet 1, 2, 3 dhe 4, dhe raporti i vlerësimit të jashtëm u ndryshua, ndërsa komenti 5 nuk u mor në konsideratë dhe Raporti nuk ndryshon.

## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE

(të dhëna nga Këshilli i Akreditimit në vendimin për akreditimin e parë, Nr. 133, datë 21.12.2010, akredituar me UMAS, Nr. 68, datë 14.02.2011, me afat gjashtë (6) vjeçar).

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit për programin e studimit

- Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësimin me kohë të plotë.
- Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si p.sh., te programi “MNP Shkenca Komunikimi”, “MND Marrëdhënie Ndërkombëtare”, etj.
- Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitetet e tjera.
- Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND.
- Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

**Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësimin me kohë të plotë.**

Për këtë rekomandim Grupi i Vlerësimit të Jashtëm diskutoi gjatë takimeve të ndara që zhvilloi ditën e parë me rektorin e UET-it, dekanin dhe përgjegjësen e Departamentit, me grupin e stafit akademik që ishin të angazhuar në këtë program master i shkencave, si dhe ditën e dytë të vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore, ku pati rast të shqyrtonte praktika konkrete të procedurës së rekrutimit të stafit, të plotësimit të dosjeve nga secili prej pedagogëve (të brendshëm ose të jashtëm). Të dhënat konkrete të angazhimit të stafit akademik deri në momentin e vizitës në institucion janë paraqitur në tabelën përkatëse të paraqitur në aneks. Evident ishte fakti se rregullimi me kontratë standard i angazhimit në UET nuk lejonte punësimin me kohë të plotë të njëkohshëm dhe në këtë universitet edhe në një institucion tjetër. Kurse angazhimi i personelit akademik të UET-it që kishte kontratë për punësim me kohë të plotë lejohej jashtë universitetit në formën e projekteve apo si konsulencë (me kohë të pjesshme), por kjo duhej të ishte e deklaruar si pikë më vete në kontratë. Një pjestar i stafit në UET me kohë të plotë punësimi deklarimin për angazhimet e tjera jashtë institucionit e bënte ose në momentin kur nënshkruante kontratën individuale, ose kur angazhimi fillonte pas nënshkrimit të kontratës. Në rastin e dytë veprime me deklaram duke plotësuar formularin G.I.10.3, që përfshinte jo vetëm prezantimin e angazhimit jashtë institucionit, por dhe dhe miratimin nga Administratori.

*Për këtë Program, mendojmë se rekomandimi i mësipërm është plotësuar.*

**Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si p.sh., te programi “MNP Shkenca Komunikimi”, “MND Marrëdhënie Ndërkombëtare”, etj.**

Nga diskutimi që zhvilluam me stafin akademik, me drejtuesin e Departamentit dhe Dekanatit, me zyrën e zhvillimit të kurrikulave dhe zyrën e koordinimit të studimeve Master u njohëm me përpjekjet për profilizimin e këtij programi shkencor në mënyrë që të përputhet me misionin dhe objektivat e IAL-së, por dhe standardeve të njohura të kësaj fushe të edukimit dhe kërkimit shkencor, si dhe nevojave që ofron tregu konkret i punës. Procesi i

profilizimit ka qenë hierarkik, me pikënisje nga departamenti e duke vijuar në rang fakulteti e deri në rang universiteti, por dhe ka qenë sistematik, duke reflektuar në mënyrë të vazhdueshme propozime dhe nisma për përmirësimin e kurrikulës së programit. Nga dy profilet që ka ky program master i shkencave, procesi ka dhënë impakt tek “Marrëdhënie Publike”, një profil me dinamikë të qëndrueshme në aspektin e kërkesave që ka për t’a ndjekur nga ana e studentëve, të cilët nivelin e parë të studimeve e kanë kryer në UET ose në IAL të tjera. Kurse për “Studime dhe Teoritë e Komunikimit” situata është “standby”/ vendnumëro, pasi pavarësisht ofertës që ka Departamenti në tre vitet e fundit nuk ka pasur interesim nga studentët për t’a kryer ciklin e dytë master i shkencave në këtë profil. Në kuadër të përshtatjes për të aplikuar zgjidhjet më të efektshme, ky profil do të jetë sërish objekt përmirësimesh të planeve mësimore, madje dhe sikundër u shprehën dhe disa nga pjestarët e stafit akademik deri dhe tek ndryshimi i emërimit të profilit.

*Mendojmë se ky rekomandim është plotësuar.*

**Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitet e tjera.**

Programi Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike”, si pjesë ofertës së studimeve dhe procesit kërkimor shkencor në UET është përfitues dhe i projekteve të përbashkëta që ka ky universitet me institucione homologe, rrjete universitare, programe ndërkombëtare etj. Gjatë takimit me stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm të programit, me studentë të vitit të parë apo të dytë, me rektorin e UET-it, me përfaqësues të zyrës së projekteve për kërkim dhe zhvillim, por dhe nga informacioni që morëm nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm u evidentua se janë arritur rezultate konkrete nga procesi i mobilitetit të stafit akademik, si dhe të studentëve, në kuadër të zbatimit të projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit Europian; si dhe të projekteve kërkimore dhe rrjetëzimit si COST dhe Horizon2020 po të Komisionit Europian.

UET-i bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë në Europën Juglindore dhe BE, në kuadër të programeve Tempus, Jean Monnet etj., si dhe me programe mbështetëse për kërkimin nga donatorë ndërkombëtarë dhe lokalë si Regional Research Promotion Programme; NUFFIC, Assist Impact/USAID, Fondacioni Shoqëria e Hapur, American - Albanian Development Fund, Swiss Development Cooperation, Agjencitë e UN, etj. Ndërkohë që bashkëpunon me Universitetin e Aston-it në Britaninë e Madhe në kuadër të programeve të Shkollës Doktorale dhe është pjesë e UNIMED - rrjet universitetesh mesdhetare me qëllim shkëmbimin e stafit dhe studentëve (Itali); FEDE - rrjet europian universitetesh me qëllim kërkimin shkencor (Portugali); është pjesë e SEUN - rrjet partnerësh mbi startup, sipërmarrjen rinore dhe inovacionin (Spanjë); UNIMED- Rrjet universitetesh mesdhetare me qëllim shkëmbimin e stafit dhe studentëve (Itali) etj.

*Në vlerësimin tonë ky rekomandim është plotësuar.*

**Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND.**

Nga kontaktet me përfaqësues të stafit akademik të brendshëm, drejtuesit i departamentit dhe dekanatit, me studentët që ndjekin aktualisht programin në vitin e parë dhe të dytë, si dhe nga të dhënat që morëm në sekretarinë mësimore të UET-it nuk rezultoi se kishte ndonjë kriter mesatareje për rekrutimin e studentëve, dmth nuk kishte “stekë” kufizuese për ndjekësit e këtij programi master i shkencave. Por numri i kufizuar i studentëve, rreth 25 për secilin vit akademik, përbënte për departamentin përkatës një kriter indirekt për cilësinë e pranimit në këtë program studimi, pasi bëhej përzgjedhje mes aplikuesve kur kishte raste që ato të ishin më të larta se kuota e caktuar. Kjo situatë ishte për profilin “Marrëdhënie

Publike” ndërsa për “Studime dhe Teoritë e Komunikimit” nuk bëhej fjalë për aplikim të ndonjë kriteri mesatareje, nga shkak i mosinteresimit për këtë profil në tre vitet e fundit akademike.

Sa i takon nivelin e njohurive në gjuhën e huaj, kjo konsiderohet si e tejkaluar, pasi bazuar në përmirësimet e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, ka kriter strikt për gjuhën e huaj, për cilindo student aplikant në nivelin e dytë të studimeve dhe kjo zbatohet nga UET-i.

*Në vlerësimin tonë ky rekomandim është plotësuar.*

### **Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor.**

Përfshirja e studentëve në procesin e kërkimit shkencor gjatë kryerjes së këtij program master ishte në fokus të diskutimeve që zhvilluam me vetë studentët, por dhe me stafin akademik në department, nga ku u njohëm me format e tyre të angazhimit. Vetë procesi i ideimit dhe përgatitjes së punimit të diplomës, ndjekja e seancave metodologjike si dhe konsultimet me udhëheqësin deri në finalizimin e punimit mbetj në qendër të vëmendjes për secilin prej studentëve të vitit të dytë. Por disa nga studentët e programit master i shkencave ishin të përfshirë konkretisht dhe në projektet studimore shkencore të pedagogëve të departamentit me kontribute që ishin në përputhje me nivelin e njohurive dhe përgatitjes së tyre. Gjithashtu në program kishte dhe studentë që ishin përfitues nga përfshirja në projekte mobiliteti në kuadër të Erasmus+, apo në programe dhe projekte ku UET-i ishte partner.

*Ky rekomandim është plotësuar.*

## **1. Misioni/Objektivat e programit të studimit**

### **Pjesa përshkimore**

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Mbështetur në Raportin e vlerësimit të brendshëm dhe në takimet e zhvilluara në UET mund të shkruajmë që:

*Programi Master i Shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike”, i cili përfshin dy profile (“Marrëdhënie Publike” dhe “Studime dhe Teoritë e Komunikimit”) synon të aftësojë studentët në hulumtimin dhe përvetësimin e thelluar të teorive dhe modeleve bashkëkohore të komunikimit, të ndara sipas disa prej fushave kryesore të zbatimit të tyre në politikë, në shoqërinë civile, biznes etj. Gjithashtu programi ka për mision kryesor përgatitjen e ekspertëve të komunikimit me aftësinë dhe kapacitetin e të angazhuarve në menaxhimin e marrëdhënieve publike në sektorë të ndryshëm. Theks i veçantë i vihet forcimit të aftësive konkrete profesionale përmes studimit të strategjive bashkëkohore, si dhe modeleve më të suksesshme të komunikimit publik.*

Përveç dimensionit akademik dhe teorik kjo diplomë ofron edhe lëndë me një theks të qartë praktik që lejon studentët të përfshihen në aktivitete konkrete formuese dhe aplikative. Kjo diplomë thekson kompetencën akademike në fushën e shkencave të komunikimit dhe krijon bazat e nevojshme për studime më të thelluara në doktoraturë.

Profili “Marrëdhënie Publike” synon të përgatisë ekspertë të komunikimit politik dhe organizativ të aftë për të punuar në departamentet e medias të institucioneve publike dhe private, kurse profili “Studime dhe Teoritë e Komunikimit” synon studimet e thelluara në

teoritë e aplikuara të komunikimit si edhe të aftësojë studentët në analiza semiotike dhe ligjërimore të fenomeneve sociale dhe politike.

Misioni kryesor i zhvillimit të këtij master i shkencave është krijimi i një hapësire mësimore dhe studimore në përgatitjen e ekspertëve të fushës që do të kontribuojnë në zhvillimet lokale, kombëtare dhe rajonale si dhe proceset integruese rajonale, ballkanike dhe mesdhetare; të aftë për t'u fokusuar në çështjet e demokracisë, zhvillimit të shkencave sociale, reformave juridike, demokratizimit të partive politike, zgjidhjeve të konflikteve, zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajonit, trashëgimisë kulturore dhe historike, migracionit, zhvillimit të tregut të punës, sinergjisë midis arsimit dhe tregut të punës etj.

Programi funksionon në kuadër të misionit dhe objektivave kryesore të UET-it, të cilat fokusohen në këto aspekte kryesore: zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në shërbim të nevojave dhe prioriteteve të zhvillimit të vendit; dhënia përparësi kërkimit shkencor, me fokus të veçantë në kërkimet ekonomike, sociologjike, antropologjike, juridike dhe të edukimit; sigurimi i cilësisë akademike; përqasja e programeve me kuadrin kombëtar të kualifikimit; rritja e investimeve dhe burimeve financiare për mësimdhënien, për inovacionin dhe punën kërkimore shkencore; përqasja sociale, rritja e kontributit të UET-it për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit; përgjegjësia sociale, rritja e përgjegjësisë së universitetit në shërbim të kohezionit social, në ndihmë të grupeve të popullsisë në nevojë dhe cilësisë së jetës së popullsisë së vendit; riorganizimin e institucionit dhe ofrimin e programeve të reja të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës etj.

Sikundër e përmendëm më lart, duhet ritheksuar se për njërin nga profilet e Programit, ai "Studime dhe Teoritë e Komunikimit" ka një gjendje vendnumëro, pasi pavarësisht ofertës që ka Departamenti në tre vitet e fundit nuk ka pasur interesim nga studentët për t'a kryer ciklin e dytë master i shkencave në këtë profil.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve<sup>1</sup></b>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave "Komunikim – Marrëdhënie Publike" është ideuar dhe po zbatohet mbështetur në misionin dhe qëllimin e UET-it, për përgatitjen e ekspertëve të komunikimit me aftësinë dhe kapacitetin e të angazhuarve në menaxhimin e marrëdhënieve publike në sektorë të ndryshëm, forcimit të aftësive konkrete profesionale përmes studimit të strategjive bashkëkohore, si dhe modeleve më të suksesshme të komunikimit publik.</p> <p>Për t'i lejuar studentët të përfshihen në aktivitete konkrete formuese dhe aplikative, duke krijuar bazat e nevojshme për studime më të thelluara në doktoraturë.</p> <p>Programi studimor dhe plani mësimor në këtë program është konsultuar me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve përkatëse, të</p>

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	<p>organizuar në formën e Bordeve të Tregut të Punës në nivel departamenti, por dhe duke marrë në konsideratë mendime nga ish-studentë të programit (anëtarë të UET Alumni), që janë diplomuar në vite, me qëllimin e përshtatjes me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Programi Master i Shkencave në “Komunikim-Marrëdhënie Publike”, përshtatet dhe me tipare dhe dinamikat e zhvillimit ekonomik të vendit. Në përgatitjen e ekspertëve të fushës që do të kontribuojnë në zhvillimet lokale, kombëtare dhe rajonale, si dhe proceset integruese rajonale, ballkanike dhe mesdhetare; të aftë për t’u fokusuar në çështjet e demokracisë, zhvillimit të shkencave sociale, reformave juridike, demokratizimit të partive politike, zgjidhjeve të konflikteve, zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajonit etj.</p> <p>Programi në strukturën e vet që realizohet brenda dhe jashtë auditorëve të UET-it reflekton synimin e këtij institucioni për respektimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>
--	--

**Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Ky program përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit, që synon të arrijë dhe të konsolidojë një pozicion dinjitoz, në mësimdhënie dhe në shkencë brenda dhe jashtë vendit, të ndihmojë në progresin e dijes njerëzore, në krijimtarinë dhe praktikën profesionale, me qëllim që të krijojë impakt mbi shoqërinë dhe ekonominë nëpërmjet transferimit të dijes përtej komunitetit akademik, tek institucionet publike e private dhe grupet e interesit, të perfeksionojë mësimdhënien dhe zhvillimin akademik në të gjitha nivelet, në mënyrë që studentët të përjetojnë një përvojë dhe një kulturë akademike sfiduese etj.</p>
---	---

**Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Përmbajtja e këtij program studimi mbetet në përputhje me kriteret ligjore dhe akteve nënligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Nga pikëpamja e zbatimit konkret të profilit të dytë të programit, “Studime dhe Teoritë e Komunikimit”, ka problem se në tre vitet e fundit, nuk është shfaqur interes nga studentët për ta ndjekur atë. Autoritetet akademike në UET dhe përfaqësues të stafit mësimdhënës dhe kërkimor në Departamentin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun mbeten me arsyetimin për ta mbajtur këtë profil, si domosdoshmëri në tregun e arsimit të lartë, bazuar në nevojat që do të ketë për ekspertë të një fushe të tillë</p>
--	--



	<p>me tipare përvetësimit dhe hulumtimit teorik. Por mbrojtësit e këtij opcioni janë të ndërgjegjshëm për nevojën për ndërhyrje, modifikime dhe përshtatje në kurrikul, për ta bërë profilin më tërheqës për të interesuarit. Një ndryshim që lidhet dhe me procesin e natyrshëm të përmirësimeve në rang fakulteti dhe departamenti. Sipas mendimeve të shprehura në takimet me stafin akademik dhe drejtuesit në institucion, gjithçka aktualisht është në evidencim dhe përpunimin e propozimeve që bëhen nga grupi i interesit, për të artikuluar më pas hapa konkretë vendimarrje në funksion të përmirësimit, hapa të cilët do të kryen bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, por dhe në dokumentet themelore të funksionimit të UET-it.</p> <p>Programi Master i Shkencave në “Komunikim – Marrëdhënie Publike” është emërtuar në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Ndoshta emërtimi i profilit të dytë të këtij programi, “Studime dhe Teoritë e Komunikimit”, do të duhet të ndryshojë në të ardhmen, por kjo është pjesë e procesit të ndryshimeve potenciale që do të realizohen, sipas shpjegimeve të mësipërme.</p>
--	---

**Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Programi i studimit ofron dije të thelluara teorike dhe praktike që krijojnë shprehi profesionale tek studentët, të cilat janë më shumë të kërkuara në tregun e punës. Programi merr parasysh njohuritë e fituara nga studentët në ciklin Bachelor dhe duke i rikapituluar ato në funksion të thellimit të metejshëm, aspect që favorizon dhe ingranimin e atyre studentëve që i bashkohen programit pa kryer në nivelin e parë studimet në të njëjtën fushë. Por përmbajtja e programit studimor nuk ka qenë e palëvizshme ndër vite, në mënyrë sistematike ndërhyhet për përmirësimin e tyre dhe në këtë rishikim janë mbajtur parasysh objektivat kombëtare të zhvillimit. Në qendër është kontributi për formimin demokratik qytetar të studentëve, të aftë për punë, në shërbim të shoqërisë së të ardhmes, ekonomisë së dijes dhe informacionit</p> <p>Ky program studimi master i shkencave është pjesë hartimit dhe miratimit të strategjisë 5 vjeçare të mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve, që ka miratuar UET-i.</p>
---	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike” merr parasysh njohuritë e fituara nga studentët në ciklin Bachelor dhe duke i rikapituluar ato në funksion të thellimit të metejshëm, aspect që favorizon dhe ingranimin e atyre studentëve që i bashkohen programit pa kryer në nivelin e parë studimet në të njëjtën fushë. Programi nuk ka qenë i palëvizshme ndër vite, në mënyrë sistematike është ndërhyrë për përmirësimin

dhe në këtë rishikim janë mbajtur parasysh objektivat kombëtare të zhvillimit.

Profili i dytë i këtij programi titulluar “Studime dhe Teoritë e Komunikimit”, ka nevojë për ndërhyrje, modifikime dhe përshtatje në kurrikul, për ta bërë më tërheqës për studentët e interesuar. Një ndryshim që lidhet dhe me procesin e natyrshëm të përmirësimeve në rang fakulteti dhe departamenti. Procesi aktualisht është në fazën e evidentimit dhe përpunimit të propozimeve që bëhen, për të artikuluar më pas hapa konkretë vendimarrje në funksion të përmirësimit, hapa të cilët do të kryen bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, por dhe në dokumentet themelore të funksionimit të UET-it.

Programi Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike” plotëson standardet mbi qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies e kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekjen dhe përshtatjen e objektivave dhe e qëllimeve me aktualitetin.

## **2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamenti përgjegjës për programin e studimit)**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit në UET, është një nga tre fakultetet e këtij institucioni (krahas Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit, si dhe Fakultetit Juridik). Ky fakultet ka në përbërje 3 departamente:

- Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, përgjegjës për programin e studimit
- Departamenti i Edukimit,
- Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara,

Secila nga këto njësi bazë ka në përbërje disa grup lëndësh, të cilat i përgjigjen në mënyrë kapilare për përmbajtjen e lëndëve të përafërta.

Programet e studimit të Ciklit të Dytë synojnë përgatitjen e specialistëve me njohuri të thelluara, duke filluar që nga çështjet e sondazheve të opinionit publik, debateve bashkëkohore, ideologjive dhe lëvizjeve të reja politike, teknikave të këshillim/vlerësimit dhe zhvillimit të fëmijës dhe adoleshentit, psikopatologjive, vlerësimeve dhe testeve të kurrikulave, didaktikave, administrimit shkollor dhe psikologjive e edukimit, deri në çështje të sigurisë/strategjisë, protokollit diplomatik, menaxhimit të sektorit publik, teknikave të advokim-lobimit, teknologjive të informacionit dhe komunikimit, dizajnit etj.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit

Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit (per vitin akademik 2016-2017 përbëhet nga 57 anëtarë të angazhuar me kohë të plotë, prej të cilëve 41 janë me grada dhe tituj akademikë, ndërsa për vitin akademik 2017-2018 përbëhet nga 59 anëtarë të angazhuar me kohë të plotë, prej të cilëve 43 janë me grada dhe tituj akademikë.

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike ka pasur përbërjen e tij si më poshtë:

- Per vitin 2014-2015 gjithsej 13 pedagogë/5 me tituj-gradat
- Për vitin 2015-2016 gjithsej 13 pedagogë/8 me tituj-gradat
- Për vitin 2016-2017 gjithsej 16 pedagogë/14 me tituj-gradat
- Për vitin 2017-2018 gjithsej 15 pedagogë/12 me tituj-gradat

(mbështetur në Tabelat 1, 2, në Aneks).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga IAL, si dhe përmbajtja e raportit të vlerësimit të brendshëm dinamika e strukturimit akademik të fakultetit dhe departamentit që është përgjegjës për këtë Program është e përgjithshme e qëndrueshme, ku afrimi i personelit vit pas viti është bërë duke respektuar kërkesat për gradat dhe titujt shkencorë. Pjesa e pedagogëve që është përfshirë për kohë të gjatë në Program ka evoluar dhe në karrierën akademike, përmes marrjes së gradës dhe titujve, tregues që ndikojnë në përmbushjen e standardit

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Në shqyrtim të strukturës organizative të të gjithë universitetit, ajo i përshtatet dhe i përgjigjet misionit dhe objektivave që ka UET.</p> <p>Ky universitet jopublik, bazuar në kuadrin ligjor që është në fuqi, ka tre fakultete (Ekonomik &amp; TI, Shkencat Sociale &amp; Edukimi, dhe Juridiku).</p> <p>Fakulteti Ekonomik &amp; TI, si dhe Shkencat Sociale &amp; Edukimi janë të organizuara në 3 departamente, kurse Fakulteti Juridik ka 2 departamente dhe 1 qendër kërkimore.</p> <p>Personeli akademik i njësisve bazë i përgjigjet si kërkesave ligjore ashtu edhe nevojave të institucionit për të mbuluar ngarkesën mësimore të programeve të studimit.</p> <p>Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit përbëhet nga 59 anëtarë të angazhuar me kohë të plotë, prej të cilëve 43 janë me grada dhe tituj akademikë, nga të cilët 15 anëtarë (12 me grada e tituj) i përkasin Departamentit të Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike që është përgjegjës për programin e studimit MSc. në Komunikim – Marrëdhënie</p>

	publike
<b>Standardi II.3 - Njësiti e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësiti bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësiti bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike si njësi përgjegjëse kryesore e ecurisë dhe mbarëvajtjes së programit Master i Shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike” është i angazhuar për ta mbajtur stafin akademik me kohë të plotë apo ata me kohë të pjesshme në funksion të plotësimin të objektivave në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, duke ndjekur seancat mësimore me studentët që ndjekin programin, praktikat apo seancat metodologjike në procesin e realizimit të punës së diplomave.</p> <p>Departamenti ndjek standardin e zhvillimit të në mënyrë të rregullit të mbledhjes javore (e fiksuar për të martën pasdite), si një mundësi për të diskutuar problematika korrente të departamentit, për të garantuar mbarëvajtjen e zhvillimit të programeve të studimit. Ka dokumente të hartuara dhe miratuara nga institucioni, bazuar në Statut, që precizojnë funksionet dhe detyrat e njësisë bazë. Ndër funksionet kryesore të departamentit janë: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve), si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin propozimeve të përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies etj.</p> <p>Në procesin e rekrutimeve të personelit të ri akademik departamenti bën propozimet për profilin e nevojshëm të kandidatit për plotësimin e vendit vakant, në përputhje me ngarkesën mësimore që ai nevojitet të plotësojë. Përgjegjësi i departamentit është anëtar i komisionit të rekrutimit të personelit të ri akademik, gjithashtu përgjigjet dhe për vlerësimin e performancës së stafit akademik të departamentit gjatë vitit akademik. Aspekte thelbësore që vlerësohen periodikisht janë psh korrektesa në respektimin e orarit të punës; zhvillimin e mësimin, dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike; cilësinë e mësimdhënies në auditor etj.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Struktura e fakultetit plotëson standardet mbi përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit.</p> <p>Duke shqyrtuar treguesit e vlerësimit të brendshëm, por dhe nga diskutimet që u zhvilluan në</p>	

ambjentet e UET-it, si dhe dokumentacioni që u paraqit për grupin e vlerësimit të jashtëm, konstatohet se si Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, ashtu dhe njësia bazë e tij, Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike që është përgjegjës për programin e studimit master i shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike” janë të strukturuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, dhe nevojat për të ofruar programe studimi cilësore në tre nivelet e studimit.

Departamenti plotëson standardet në performancë, duke qenë i ndërgjegjshëm për rolin e rëndësishëm që ka në drejtimin dhe menaxhimin e përditshëm të programit të studimit, ku ndër funksionet kryesore janë: shqyrtimi dhe miratimi i planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve), si edhe propozimi i ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimi dhe miratimi propozimeve të përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekja e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies etj.

Në procesin e rekrutimeve të personelit të ri akademik departamenti bën propozimet për profilin e nevojshëm të kandidatit për plotësimin e vendit vakant, në përputhje me ngarkesën mësimore që ai nevojitet të plotësojë. Aspekte thelbësore që vlerësohen periodikisht janë psh korrektesa në respektimin e orarit të punës; zhvillimin e mësimit, dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike; cilësinë e mësimdhënies në auditor etj.

### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Rregullimi i angazhimit të personelit akademik dhe personelit mbështetës për programin Master i shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie publike” me profile: *a. Studimet dhe teoritë e komunikimit, b. Marrëdhënie publike*, bazohet në kontratat individuale që lidhen mes tyre dhe institucionit. Format i kontratës përputhet me kërkesat e Statutit të UET, por mbi të gjitha dhe me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Stafi akademik dhe drejtuesit kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e UET-it, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative.

Personeli akademik ndahet në të punësuar me:

- kohë të plotë; që është me kontratë me afat ose pa afat, dhe përbëhet nga drejtuesit, personeli akademik i brendshëm;
- kohë të pjesshme, që përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, profesorë “emeritus” ose pedagogë “senior” dhe lektorë të ftuar.

Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat përkatëse në Statutin e UET-it dhe me dokument të veçantë.

Emërimi i tyre është e drejtë ekskluzive e Rektorit. Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe UET-it,

bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e UET-it, në rregulloret, në Kodin e Etikës dhe në Kodin e Integritetit Akademik, si dhe në dokumentet e tjera të miratuara nga organet drejtuese të UET-it.

Në ngarkesën akademike përfshihen: mësimdhënia (së bashku me kualifikimin e vazhdueshëm profesional); kërkimi shkencor; transferim të teknologjisë dhe njohurive dhe shërbime; detyra administrative.

Vlerësimi i performancës së stafit për mësimdhënien ka në bazë raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në UET, si edhe opinionin e studentëve, që vilet përmes pyetësorit që shpërndahet periodikisht për ta në fund të semestrit. Duhet thënë se nga monitorimi konkret i përfshirjes së studentëve në plotësimin e pyetësorëve ka pak interesim prej tyre për një gjë të tillë (rreth 25 përqind) edhe pse sistemi ruan konfidencën e personit që jep përgjigje.

Nevojat për personel të ri akademik rezultojnë pas analizave të hollësishme të kapaciteteve dhe ngarkesave që evidenton departamenti, që ka të drejtën të bëjë paraqitjen e propozimit për rekrutim personeli akademik në Këshillin e Fakultetit. Propozimi përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, si dhe argumentimin e këtij propozimi, dhe në varësi të ngarkesës që pritet të mbulojë, nëse nevojitet pedagog i brendshëm ose i jashtëm. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidatëve në programin Komunikim-Marrëdhënie Publike, janë treguesit e performancës së kandidatëve, të tillë si:

- përvoja në mësimdhënie në nivel universitar dhe pasuniversitar;
- të ketë së paku gradë shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Profesor, Profesor i Asociuar, Akademik;
- cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore;
- rezultatet personale të kandidatit;
- aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me objektivat shkencorë të UET-it;
- motivet kryesore për t'u bërë pedagog në UET;
- aftësitë komunikuese dhe etika;
- objektivat e tij afatmesëm dhe afatgjatë në karrierën akademike e shkencore;
- përvoja e punësimit dhe rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm;
- zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre;
- paraqitja gjatë intervistës nga komisioni i posaçëm i rekrutimit;
- paraqitja gjatë leksionit të hapur para Departamentit përkatës (kur aplikohet).

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura didaktike (seksionet) për programin e studimit. Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat. Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat 3 në Aneks, të cilat janë plotësuar edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)**

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personeli Akademik me Kontratë (PAK) janë në përputhje me dispozitat ligjore për organizimin e strukturave didaktike për programet e studimit.

**Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (Tabela 4 në Aneks)**

Këshilli Shkencor i Programit të Studimit (për aq vite sa ka funksionuar) dhe Koordinator mbulojnë të gjitha programet e studimit master në UET

**Të dhënat sipas seksit dhe sipas moshës së personelit**

Të dhënat sipas seksit dhe sipas moshës së personelit jepen në Aneks (Tabela 5)

**Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

Nga informacioni që patëm në dispozicion në Zyrën e Burimeve Njerëzore, por dhe nga takimi me personelin akademik të përfshirë në Program evidentuam se formati i kontratës së punës ishte konform legjislacionit në fuqi, Kodit të Punës dhe akteve rregullatore të UET. Personeli kishte njohuri mbi të drejtat dhe detyrat që lindin nga zbatimi i kontratës, si dhe për rastet kur pedagogu i brendshëm apo i jashtëm kishte angazhime të tjera jashtë UET-it. Për pedagogët e brendshëm ndalohej punësimi me kohë të plotë jashtë UET-it, ndërkohë që për angazhime të ndryshme a përfshirje në projekte me kohë të pjeshme bëhej njoftim paraprak.

**Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë**

Rekrutimi i stafit ndihmës/ administrativ për Departamentin, bazuar në dokumentacionin e paraqitur ishte sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, por dhe standardeve të punësimit në UET. Ata ishin me kontrata pune dhe personeli akademik si dhe studentët që ndiqnin Programin vlerësuan cilësinë e punës dhe angazhimit të tyre, si për mbarëvajtjen e procesit mësimor ashtu dhe atë kërkimor.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;  <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ është në korrent për nevojën e zbatimit të objektivave të programeve të studimit dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Kontakti me dokumentacionin bazik rregullator që është i aksesueshëm nga secili përmes publikimit virtual në intranet dhe LMS në një folder të vecantë.  Në mënyrë sistematike performanca e stafit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ mbikqyret nga njësi K/SBC, Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, që adreson dhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e kërkuar, në përputhje me objektivat, strategjinë dhe aktet rregullatore në fuqi.
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Departamenti është përgjegjësi dhe promotori për vendimarrjen në hartimin dhe rishikimin e kurrikulave. Pjesë e diskutimeve në mbledhjet javore apo ato që zhvillohen në periudha më pak të shpeshta janë dhe evidentimi e trajtimi i propozimeve që bëjnë anëtarët e departamentit. Prej këtej propozimet e argumentuara përcillen më tej për miratim, në strukturat vendimarrëse të Fakultetit e më tutje në Senatin Akademik të UET.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik merr në konsideratë kërkesat ligjore dhe përcaktimeve në rregulloren e brendeshme.</p> <p>Një kufizim është që një pedagog nuk mund të zhvillojë më shumë se 4 lëndë në vit. Në programin master i shkencave përfshihen vetëm pedagogë me grada dhe tituj.</p>
<p><b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>UET i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht në faqen online të UET-it, por dhe në gazetën MAPO (e përditshme që publikohet nga universiteti) dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Konkurset janë sistematike dhe krijojnë lista potenciale me aplikues, të cilët rekrutohen në momentin e krijimit të një vendi të lire.</p> <p>Programi master i shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike” aktivizon së paku 70% të personelit akademik me kohë të plotë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për vitin 2015-2016 rezulton se 90% e programit është mbuluar nga PAE</li> <li>• Për vitin 2016-2017 rezulton se 82 % e programit është mbuluar nga PAE</li> <li>• Për vitin 2017-2018 rezulton se 92.5% e programit është mbuluar nga PAE</li> </ul> <p>Vlerësimi i performancës së pedagogëve ka disa nivele: vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit; vlerësimi nga studentët: vlerësimi nga drejtuesit e UET në fund të vitit akademik (procesi follow-up).</p> <p>Në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Arkivit ka dokumentacion të praktikës së rekrutimit të personelit, gjenden dosje të aplikantëve, të komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve të shpallura për punë.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit është me gradën Prof.Asoc. Dr. dhe me përvojë akademike.</p> <p>Pedagogët e angazhuar në zhvillimin e programit të studimit janë pedagogë me grada dhe tituj (2 me titull Profesor Doktor, 5 me titull Profesor i Asociuar, 5 me gradë shkencore Doktor, dhe 1 asistent lektor në</p>



<p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>përfundim të studimeve të doktoratës).</p> <p>Mesatarisht në tre vitet e fundit mbi 88 % e ngarkesës së programit është realizuar me pedagogë të brendshëm. Sa i takon personelit të jashtëm, vlen të theksojmë se të gjithë kanë mbi dy vjet që angazhohen në UET, gjë që dëshmon për qëndrueshmërinë e bashkëpunimit me institucionin.</p> <p>Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndër- universitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron këtë program studimi master i shkencave;</p> <p>Raporti pedagogë/studentë është mjaft i ulët çka mundëson një përkushtim mjaft të madh të personelit akademik ndaj studentëve të programit, dhe mbikëqyrje të mirë të praktikave profesionale.</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi, gjatë vitit të dytë të studimeve përgatisin dhe mbrojnë një punim diplome.</p> <p>Udhëheqësi i tezave është pedagog me gradë dhe/ose titull, i cili krahas takimeve të personalizuara, zhvillon edhe seanca metodologjike në auditor me grupin e studentëve që udhëheq, për të garantuar një mbarëvajtje të procesit të shkrimit të punimit.</p> <p>Udhëheqësit për temat me karakter kërkimor në masterin i shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike”, nuk e tejkalojnë kufirin e parashikuar për numrin e njëkohshëm të studentëve që ndjekin..</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Studentët njoftohen për listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës. Departamenti gjatë shqyrtimit të propozimeve të studentëve për temën e tezës master garanton që udhëheqësi i propozuar nga studenti të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar. Nëse nuk konstatohet përputhshmëri, atëherë departamenti cakton një pedagog udhëheqës që i përmbush këto kritere.</p> <p>Nëse nuk ka pedagogë të brendshëm të përshtatshëm për të udhëhequr një temë të caktuar, atëherë departamenti ka të drejtë të caktojë në pedagog të jashtëm brenda kritereve të kërkuara</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve</p>	<p>Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në</p>

<p>shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimit. Gjithashtu personeli administrativ është gjithmonë në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale në UET funksionon Zyra e Karrierës dhe Praktikave, e cila ka lidhur memorandume bashkëpunimi me shumë institucione publike dhe kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione.</p>
---	---

**Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli i angazhuar në programin master i shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike” realizon ngarkesën mësimore sias akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET-in.</p> <p>Pedagogët me grada e tituj duhet të plotësojnë ngarkesën fillimisht në ciklin e dytë dhe të tretë. Një orë fizike në auditor llogaritet 1.25 orë njësi për efekt ngarkese.</p> <p>Edhe proceset e tjera akademike si udhëheqjet e diplomave, oponencat, mbikëqyrjet e praktikave profesionale konvertohen në orë mësimore njësi</p>
--	--

**Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar në dokumentat bazë të funksionimit të UET, departamentet për programet dhe lëndët që menaxhojnë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna të detajuara në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit, ngarkesën që mbulon.</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik përcaktohen me dokument dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. të veçantë, pjesë e broshurës së dokumenteve UET dhe publikohen në faqen e internetit dhe media sa herë që ka shpallje të vendeve vakante.</p>
--	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se në Programin Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie publike” plotësohen standardet mbi kualifikimin e personelit akademik, ndarja e tij në të brendshëm dhe të jashtëm, shpërndarja e ngarkesës, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Mesatarisht në tre vitet e fundit mbi 88 % e ngarkesës së programit është realizuar me pedagogë të brendshëm. Sa i takon personelit të jashtëm, vlen të theksojmë se të gjithë kanë mbi dy vjet që angazhohen në UET, gjë që dëshmon për qëndrueshmërinë e bashkëpunimit me institucionin.

Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat përkatëse në Statutin e UET-it dhe me dokument të veçantë. Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe UET-it, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e UET-it, në rregulloret, në Kodin e Etikës dhe në Kodin e Integritetit Akademik, si dhe në dokumentet e tjera të miratuara nga organet drejtuese të UET-it.

Në ngarkesën akademike përfshihen: mësimdhënia (së bashku me kualifikimin e vazhdueshëm

profesional); kërkimi shkencor; transferim të teknologjisë dhe njohurive dhe shërbime; detyra administrative. Vlerësimi i performancës së stafit për mësimdhënien ka në bazë raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në UET, si edhe opinioni i studentëve, që vilet përmes pyetësorit që shpërndahet periodikisht për ta në fund të semestrit. Stafi akademik i angazhuar për drejtimin dhe zhvillimin e programit të studimit është brenda kriteve të përcaktuara, me grada dhe tituj, si edhe eksperiencë të gjatë në mësimdhënie.

Nevojat për personel të ri akademik rezultojnë pas analizave të hollësishme të kapaciteteve dhe ngarkesave që evidenton departamenti, që ka të drejtën të bëjë paraqitjen e propozimit për rekrutim personeli akademik në Këshillin e Fakultetit. Propozimi përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, si dhe argumentimin e këtij propozimi, dhe në varësi të ngarkesës që pritet të mbulojë, nëse nevojitet pedagog i brendshëm ose i jashtëm.

#### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Universiteti European i Tiranës përbëhet nga një kompleks me tre godina funksionale (Godina A me 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>; Godina B po me 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>; Godina C (ku ndodhet biblioteka e universitetit) me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>.

Adresa është: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70, H1, Tiranë. Bazuar në dokumentacionin e institucionit aktiviteti sipërfaqja e përgjithshme e godinave është rreth 10,000 m<sup>2</sup>. Përreth godinave, ndodhet një hapësirë e gjerë për lulishte me stola të jashtëm, si dhe vend për parkim për rreth 120 makina. Objekti është i pajisur dhe me shkallë alternative për rastet emergjente të daljes, gjithashtu godinat kanë pajisje dhe mjete bazike për të vepruar kundë zjarrit: një fikse zjarri në çdo kat, dhe nga një fikse zjarri në burime potenciale zjarri, në total 30 copë, si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, përkatësisht rrufepritëse. Për qëndrueshmërinë në furnizimin me energji elektrike të mjedisëve, universiteti ka siguruar vec linjës kryesore dhe moto gjeneratorë, si edhe ka të garantuar rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, (sigurimi bëhet nga rrjeti publik i furnizimit me ujë të pijshëm, pus uji rezervë dhe sistemi i pompimit përkatës. Ngrohja e ambjentëve të brendshme bëhet nga instalimi i sistemit "fan cool", me komandim qendror. Ky sistem funksionon pa ndërprerje dhe janë certifikuar mirëmbajtje të rregullta të tij nga firma instaluese.

UET ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor; Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit) dhe 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit.

Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht webin. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, këtu përfshihen projektorët dhe sistemi i fonisë. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softwarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Sistemet e operimit janë të gjithë Windows 7, paketa Microsoft Office 2016 është instaluar e plotë me të gjithë softwarët e saj:

Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace dhe Word.

Ndërsa për programet e Informatikës së avancuar, statistikës dhe programit Master në informatikë ekonomike janë instaluar programet e mëposhtme: Navicat for my SQL; NetBeans; Apache Tom Cat; SPSS 19. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore.

UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shpesh audio vizive, etj. Ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek.; të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet.

### **Biblioteka**

Pasurimi i fondit të bibliotekës është bërë dhe vazhdon të bëhet përmes këtyre rrugëve:

(a) Blerja në fillim të çdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm tekstesh universitare dhe librash të reja që janë pjesë e kurrikulave shkollore si tekstet bazë ose si literaturë e rekomanduar;

(b) Blerja në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të çdo viti i botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me procesin mësimor në të tre fakultetet e UET-it;

(c) Përkthimi dhe botimi nga UET Press-it i teksteve (përfshirë tekste universitare dhe monografive shkencore që kanë për autorë pedagogë të UET-it, studiues të tjerë shqiptarë dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohorë. Këtu bëjnë pjesë edhe koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që janë botuar dhe botohen nga ky universitet, si Polis, Economicus, Jus dhe Justicia dhe Sociological Analysis dhe Educatio.

(d) Porosive dhe blerja online në Amazon.com e dhjetra apo qindra botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet me së miri ekspertiza e UET.

Punonjësit në Bibliotekë prezantuan abonime në biblioteka virtuale, dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë, ku rendisim: Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar), Questia; kurse revista shkencore të huaja tituj si më poshtë:

1. Harvard Business Review 2. The Economist 3. Foreign affairs 4. Commentaire 5. The Nations Interest 6. The American Interest 7. Educational Leadership etc.

(e) Të dhuruara nga organizata e shoqata të ndryshme, ambasada të huaja, individë dhe fondacione të ndryshme. Një vend të veçantë në fondin e Bibliotekës së UET-it zënë titujt e shumë akademikë (kryesisht tekste bazë dhe monografi) të botuara nga UET-Press, të cilat kanë autorë shqiptarë ose janë përkthime të disa prej botimeve më të mira dhe më të fundit të Universitetit të Oksfordit të botuara në shqip nga UET Press. Një listë e tyre mund të konsultohet në Bibliotekë. Stafi i Bibliotekës orienton studentët, stafin pedagogjik apo punonjësit e UET për të gjetur literaturën që u nevojitet. Salla ishte e arregtuar në mënyrë që për secilin përdorues të kishte kushte të përshtatshme leximi a konsultimi me fondin që shfrytëzon.

Por inventari i librave dhe periodikut që është gjendje në bibliotekë shpesh reduktohet në kopje, pasi ka dhe përdorues që nuk e kthejnë sërish inventarin e huazuar tek punonjësit e shërbimit. Mungesa e sistemeve të monitorimit dhe sinjalizimit në hyrje – dalje apo brenda mjediseve të sallës e favorizon këtë fenomen.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Bazuar në dokumentacionin e institucionit, raportin brendshëm të vlerësimit, si dhe nga verifikimi që u bë për mjaft nga treguesit gjatë vizitës dyditore, rezultoi se:

- sipërfaqja e brendshme është e ndarë në salla leksionesh, (10 salla me sipërfaqe totale 1510 m<sup>2</sup> dhe 1515 vende).
- Salla seminari janë 14, me sipërfaqe 45 m<sup>2</sup> dhe secila me nga 35 karrige.
- Salla 70 vendëshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup> secila.
- Salla për departamentet janë gjithsej 8 ambiente me sipërfaqe 45 m<sup>2</sup> secila.
- Zyra për përgjegjës departamenti janë gjithsej 8 ambiente me nga 18 m<sup>2</sup>.
- Zyra për koordinatorë janë gjithsej 6 ambiente me nga 14 m<sup>2</sup>.
- Salla për laborator informatike janë 3 salla me sipërfaqe 45 m<sup>2</sup> secila me kapacitet 35 vende.
- Sallë interneti me sipërfaqe 165 m<sup>2</sup> me 80 kompjuter.
- Zyra për pedagogët janë 30 me sipërfaqe 14 m<sup>2</sup> secila dhe një sallë e madhe me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, me 32 poste pune.
- Salla për bibliotekën ka sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, 150 vende leximi.
- Mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>.
- Zyra informacioni për studentët janë 2.
- Korridore plus holle janë gjithsej 8 me 150 m<sup>2</sup> secili.
- Mjedisi çlodhës për kafe/fastfood/etj. është në një sipërfaqe të vetme 500 m<sup>2</sup>.
- Nyje hidrosanitare janë gjithsej 48 me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>.
- Zyra për dekanin/ zv.dekanin/kancelarin janë 5 me nga 20 m<sup>2</sup>.
- Zyra për sekretarinë mësimore janë 3 me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>.
- Zyra për stafin akademik dhe administrativ janë 12 me sipërfaqe 350 m<sup>2</sup>.
- Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore janë 3 me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore; <b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet; <b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	UET përbëhet nga një kompleks me tre godina funksionale (Godina A me 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m <sup>2</sup> ; Godina B po me 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m <sup>2</sup> ; Godina C (ku ndodhet biblioteka e universitetit) me sipërfaqe 300 m <sup>2</sup> . Adresa është: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H1, Tiranë. Bazuar në dokumentacionin e institucionit aktiviteti sipërfaqja e përgjithshme e godinave është rreth 10,000 m <sup>2</sup> . Në këtë vendndodhje UET-i ka prej shtatorit 2007 dhe

<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>infrastruktura e institucionit është përmirësuar vazhdimisht duke ofruar hapësira të nevojshme dhe komode.</p> <p>Gjithashtu për një shfrytëzim optimal të infrastrukturës në dispozicion, mësimi në ciklin e parë të studimeve zhvillohet nga e hëna në të premte, 9:00-16:00, ndërsa në programet e ciklit të dytë ditëve të javës nga ora 17:00 dhe të shtunave 9:00 – 16:00.</p>
--	---

**Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka e UET është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Për realizimin e programeve biblioteka zotëron gjithsej 6005 tituj të disponueshëm për studentët, nga këto në shqip janë 4634 tituj dhe në gjuhë të huaj 1371 tituj.</p> <p>Për programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit në bibliotekë gjenden 3781 tituj (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht).</p> <p>Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkua nga pedagogët dhe studentët. Botimet periodike në total janë 162, nga këto 102 janë në shqip dhe 60 janë në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht). Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. UET bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer pedagogëve dhe studentëve. Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hënë-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00:17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur.</p>
--	--

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	<p>UET ka aktualisht në përdorim 3 laboratorë mësimorë Informatike, të cilat janë të pajisura me PC, video projektor dhe mjete të tjera audio vizive, të cilat janë përshtatshme në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve që i përdorin ato sikurse dhe janë të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p>Të gjitha sallat në të cilat zhvillohen si leksionet ashtu edhe seminarët janë të pajisura me PC dhe videoprojektor, të cilat i vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit akademik.</p> <p>Ambjentet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. Laboratorët e</p>
--	--

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

informatikë/statistikës janë pajisur me software-t e nevojshëm për zhvillimin e praktikave profesionale. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore. Sa i takon praktikave profesionale, UET ka akomoduar një numër kërkesash të studentëve për të zhvilluar praktikën në njësi të ndryshme administrative si: Bibliotekë, Librari, Zyrën e Kujdesit ndaj Studentëve, Zyrën e Karrierës dhe Praktikave, Zyrën e Aktiviteteve, Zyrën e IT-së, pranë koordinatoreve të Departamenteve.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Standardet e kërkuara nga institucioni, ku realizohet Programi Master i Shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publiku”, për mjediset, infrastrukturën, teknologjitë e informacionit, bibliotekën, shërbimet e tjera për studentët, dhe rezidencat janë plotësuar. Studentët dhe stafi akademik në ky program studimi program studimi e zhvillojnë procesin mësimor në një infrastrukturë që i plotëson standardet.

UET-i ofron në tre godinat sistem kondicionimi dhe wireless. Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projektor. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në zyra dyshe. Përgjegjësit e departamenteve, dekanët, zv. Rektorët dhe drejtuesit e tjerë janë akomoduar në zyra individuale. Në dispozicion të departamenteve janë dhe sallat e mbledhjeve.

Biblioteka ka një fond librash dhe periodikësh që është vazhdimisht në përpjekje për t’u pasuruar, si në gjuhën shqip ashtu dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore.

## **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Burim kryesor financimi janë tarifatat për dhe gjatë shkollimit, ndërsa një kontribut tjetër lidhet me aktivitetet tregtare (qeradhënie, parkim etj.) Specifike për vitet e fundit 2013-2016 është edhe kontributi i granteve për kërkim dhe kontratat.

Universiteti European i Tiranës kryen kontroll dhe audit çdo vit. UET shpik përmbush kuotat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi i pavarur ose audituesi ligjor jep opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standartet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë më 31 dhjetor, si dhe rezultatin e

operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Dokumentacioni përkatës vërtetues janë bilanci vjetore dhe raportet e auditorit të pavarur

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje shih tabelen ne RVB, faqe 25):**

- Grantet për kërkim 1-2%
- Konsulencat, shërbimet 0%
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 83-85 %
- Sponsorizimet 0%
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 0%
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj 0%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 13-16%

**Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)**

Projekti financiar hartohet në muajin korrik të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm Z. Henri Çili. Për zbatim të këtij projekti, ngarkohet Zv.Administratori dhe Zyra e Financës.

Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajis me “Kërkesë për Lëvrim fondesh”, e miratuar nga Zv.Administratori. Konsumimi i cash-it bëhet vetëm me fatura të rregullta tatimore, lëvizjet bëhen me bankë. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë që gjithmonë të ketë një rezervë të të ardhurave, duke mos përfshirë të ardhurat e vitit pasardhës, në mënyrë të tillë që të mbulohen shpenzimet në vazhdimësi për çdo student deri në diplomimin e tij.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>UET ka raport auditit çdo vit.</p> <p>Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të</b>	



<b>studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni bën një auditim të përvitshëm të situatës financiare të tij.</p> <p>Për secilin vit akademik institucioni harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare plotëson standardet e kërkuara.</p> <p>UET respekton standardin e hartimit të raportimit financiar dhe të evidentimit të kostos së studimit. Pasqyrat financiare përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.</p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sigurimit të brendshëm të cilësisë është në vëmendje të institucionit, për të garantuar që veprimtaria e tij jo vetëm të jetë në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore, por gjithashtu që objektivat strategjike.

Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga fillimi i vitit 2011 në formën e një njësie të përherëshme në strukturën organizative të institucionit (Tabela 6 në Aneks). Përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm është konsideruar një përvojë shumë e mirë për të siguruar më shumë objektivitet dhe paanshmëri në gjykimet dhe rezultatet e vlerësimit, si edhe për të marrë feedback nga ekspertë të cilët mund të sjellin perspektiva e këndvështrime të ndryshme, për të përmirësuar më tej praktikat e zbatuara.

Ngritja e organeve këshilluese si Bordi i Besimit dhe Bordet e Tregut të Punës i përgjigjet gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë (projekti TEMPUS "ENCHASE" dhe Erasmus+: QAINAL). Angazhimi në këto projekte dhe trajnimet, siç ishte pjesëmarrja e 3 autoriteteve drejtuese të institucionit në aktivitetin "International Quality Assurance Programme" të organizuar nga Agjencia Britanike QAA, i shërbejnë përditësimit me praktikat e mira të sigurimit të cilësisë.

Një formë tjetër e sigurimit të cilësisë është dhe kontrolli i provimeve të ndërmjeteme dhe atyre të semestrit. Katër herë në vit KSBC kryen këtë proces, rezultatet e të cilit pasqyrohen në raportet përkatëse.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:**

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
- Etj

Një nga format më të përdorura mbi cilësinë në UET është Pyetësi me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Ato mbeten një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit. Ndër problemet më kryesore kanë qenë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj. Duhet evidentuar fakti se nga studentët e programit master i shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike” nuk është shprehur ndonjë interes i madh për të dhënë mendime dhe vlerësime përmes pyetësorëve të drejtuesve (rreth 25% e tyre kishin marrë pjesë në dy Pyetësorët e fundit).

**Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, KSBC, e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar (Planit të veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen kontrollat në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UET.

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti**

KSBC vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të UET-it. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kërkesat në rritje për një cilësi sa më të lartë dhe përvoja e fituar në vite kanë shtruar nevojën për një transparencë në tërë proceset akademike që realizohet përmes paraqitjes në Intranet të programeve të lëndëve dhe dokumentacionit që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në UET, etj, legjislacionin përkatës, urdhërat e Rektoratit të UET-it etj. Në këtë kuadër, për secilin program lënde që është pjesë e programeve të studimit është konceptuar një format standard, ku theksi është vendosur në paraqitjen e detajuar të çështjeve që do të mbulojnë temat që trajton lënda, si dhe të literaturës përkatëse, të detyrueshme dhe plotësuese, literaturë e cila përzgjidhet me kujdes pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të fushës përkatëse dhe diskutimit sipas grup-lëndëve dhe në departament.

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

Ndikim të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit nga “fokus grupet” si edhe pyetësorët me frekuencë simestrale apo mbi një problem specifik, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo

program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog. Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të follow up-it, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik.

**☑ Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues të student apo pedagog. Çdo student, apo pedagog që hyn në sistem, merr vetëm informacionin që i përket atij. Funkzioni kryesor i këtij sistemi është të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) mes pedagogut dhe studentëve, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pasi studenti merr përmes sistemit, gjithë bazën didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t'i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme. Njëkohësisht, ai është edhe një mjet eficient në dispozicion të KSBC-së për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem. Gjatë takimeve që zhvilloam me grupin e studentëve dhe me përfaqësues të stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, u vlerësua maksimalisht ky aplikacion për komoditetin e komunikimit, si dhe të marrjes së informacionit për aspekte të ndryshme të mësimin, kërkimit shkencor, të eventeve, detyrimeve sipas programit etj.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>c. Pyetje konceptuale;</li> <li>d. Intervista;</li> <li>e. Etj.</li> </ul> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh.</li> </ul>	<p>KSBC është struktura përgjegjëse për menaxhimin vlerësimit për ecurinë e programeve të studimit në UET. Për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre ajo raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve.</p> <p>UET kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p> <p>Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit të statistikave përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre në UET, kalueshmëria për lëndë dhe pedagog, etj.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit përdoren metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p>

<p>provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>Të tërthorta: Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista;</p> <p>Të drejtpërdrejta: Teste të standardizuara; Dëgjime në auditor; Vlerësimi me pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës</p>
--	---

**Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.**

**Kriteri 1** Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

**Kriteri 2** Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese, por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel rektorati sikurse dhe në nivel departamenti.

Prezantime (raporte) mbi treguesit e cilësisë së brendshme për të gjithë institucionin, apo njësi të vecanta të tij nuk rezultoi se janë publikuar virtualisht në faqen online të institucionit.

**Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecures së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.

Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti) dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në "fokus grupe" dhe pyetësorët online, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.

**Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura

Në plotësim të standardeve institucionale UET-i është akredituar dhe riakredituar, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Programet e studimit për të cilat ka nisur procesi i

për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

akreditimit periodik, janë akredituar nga institucionet përgjegjëse.

Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe KSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të antarëve të Bordeve të Tregut të Punës si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore.

Për të siguruar cilësinë e proceseve akademike UET harton politikat përkatëse përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe strukturat e tjera në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë.

Një rol të veçantë luajnë mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, ndër të cilët përmendim atë për format e kontrollit; organizimi i pyetësorëve me studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar në UET, sistemin LMS, etj.

Ndërgjegjësimi i personelit synohet përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UET me fillimin e vitit akademik dhe gjatë vitit në takime të veçanta me drejtuesit e institucionit, pedagogët, etj.

Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të KSBC dhe reflektohet në format dhe formatet standarde të publikura në intranetin e UET.

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

UET plotëson kryesisht standardet e institucionalizimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritjen e Njesisë së SBC, funksionimin e saj, vetëvlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.

Një nga format më të përdorura mbi cilësinë në UET, për rrjedhojë dhe në programin master “Komunikim dhe Marrëdhënie Publike” është Pyetësori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Ato mbeten një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit. Duhet evidentuar fakti se nga studentët e programit master i shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike” nuk është shprehur ndonjë interes i madh për të dhënë mendime dhe vlerësime përmes përgjigjeve të pyetësorëve (rreth 25% e tyre kishin marrë pjesë në dy Pyetësorët e fundit).

Prezantime (raporte) mbi treguesit e cilësisë së brendshme për të gjithë institucionin, apo njësi të vecanta të tij nuk rezultoi se janë publikuar virtualisht në faqen online të institucionit.

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese, që ofrohen në këtë program studimi, janë të organizuara në kategori, nga A në F. Disiplinat mësimore të ofruara në kategorinë A, B, E dhe F janë të detyrueshme. Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë, në kategorinë B disiplina të formimit karakterizues të programit ku ofrohen 7 lëndë të detyrueshme për të gjithë, në kategorinë C ofrohen 2 lëndë që përcaktojnë diferencimin e profileve, në kategorinë E praktika profesionale. Gjatë vitit të dytë të studimeve, studenti përgatit edhe temën e diplomës, mbrojtja e së cilës është kusht i domosdoshëm për diplomim dhe përbën detyrimin e përfshirë në kategorinë F.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

##### Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master i Shkencave në Komunikim – Marrëdhënie Publike ndërthur njohuritë teorike me aplikimin në praktikë të aftësive të fituara. Ky program studimi synon jo vetëm të formojë specialistë të fushës, por edhe qytetarë aktivë, të aftë për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës. Nëpërmjet këtij cikli studimi synohet përgatitja e studentëve cilësorë dhe të aftë për tregun e punës.

##### Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 28 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 14 javë mësimore në auditor

##### Planit mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Tabela e Planit mësimor është paraqitur në Aneks, **Tabela 7**

##### Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Nga RVB dhe takimet në institucion rezultojnë këto ndarje:

- |                        |  |
|------------------------|--|
| ▪ Për leksionet        | 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Seminaret        | 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit   |
| ▪ Për Laboraret        | 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit  |
| ▪ Për Praktikën Profes | 255 orë në auditor dhe 45 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar | 40 orë në auditor dhe 860 orë punë e pavarur e studentit |

**Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara**

Tabela e ndryshimeve në Planin mësimor është paraqitur në Aneks, Tabela 8  
Ndryshimet rezultojnë më të vogla se 20%

**Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës**

Tabelat e Planit mësimor lidhur me stafin akademik janë paraqitur në Aneks, (Tabelat 10-1, 10-2 dhe 10-3)

Përgjithësisht pedagogët në lëndët e formimit bazë janë përzgjedhur sipas kritereve të gjithëpranuara. Nga pyetjet në auditor me studentët rezultoi se në përgjithësi ata kishin informacionin e duhur për gruplëndët e formimit bazë.

**Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë**

Syllabuset janë në përputhje me planet dhe programet e studimit të ciklit që po vlerësojmë. Ato kishin elementët si më poshtë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

**Analizë e cilësisë së syllabuseve**

Nga dokumentacioni i paraqitur nga njësia bazë evidentohej se nga trupa akademike, si pedagogët me kohë të plotë ashtu dhe ata të jashtëm vlerësohej me seriozitet dorëzimi paraprak të syllabus-eve, sipas një forme që përfshinte të gjithë aspektet bazë të përmbajtjes. Përmes tyre studentët apo të gjithë të interesuarit identifikonin mënyrën e mësimdhënies nga pedagogu i lëndës, vlerësimin, por dhe detajet mbi literaturën, detyrimet, listen e temave që do të aplikoheshin. Gjatë takimit me studentët e Programit, ata pohuan se informoheshin për lëndët që do të zhvilloheshin nga syllabus-et që ju shpërndareshin paraprakisht.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucionit ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>UET është IAL jopublik, ku programet e studimit për të cilat lëshon diplomë janë të akredituara, sipas legjislacionit në fuqi. Programet janë të organizuara në përputhje me udhëzimet e MAS dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS.</p> <p>Ngarkesa vjetore është 60 kredite, e ndarë në mënyrë të balancuar mes dy semestrave. Programet ofrohen me kohë të plotë.</p>
--	--

**Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.**

<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi master i shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike” përmbush kriteret e vendosura, pasi ofron njohuri të thelluara praktike dhe profesionale, të cilat janë shumë të kërkuara në tregun e punës.</p> <p>Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, duke bërë një përsëritje të shpejtë të nocioneve bazë për të akomoduar edhe avancimin e studentëve që nuk kanë përfunduar studimet bachelor në këtë fushë.</p> <p>Theks i veçantë është vënë tek praktika profesionale dhe punimi i diplomës. Përfundimi me sukses i programit të studimit e çon studentin në tregun e punës ose i jep mundësi atij për vazhdimin e studimeve në programet e ciklit të tretë të studimeve.</p>
--	--

**Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit, lëndët e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. -Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi të plotësojnë njohuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit.</p>
---	---

**Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.**



<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveje dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi është hartuar duke iu referuar përvojave më të mira bashkëkohore europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.</p> <p>UET-i ka ndërtuar Planin Strategjik 2015-2020, i cili parashtron edhe prioritetet për bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar.</p>
<p><b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Aftësimi profesional i studentëve realizohet jo vetëm përmes praktikës profesionale, e cila kryhet gjatë semestrit të tretë, dhe zgjat gjithë semestrin, por edhe përmes lëndëve me karakter aplikativ që ofrohen në programin e studimit.</p> <p>Aftësimi për kërkim shkencor realizohet përmes lëndëve të metodologjisë, seancave metodologjike për punimin e diplomës dhe konsultimin e vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës.</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET-it dhe drejtimet e miratuara për kërkimin shkencor.</p>
<p><b>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Që gjatë hartimit të programit të studimit departamenti është konsultuar me përfaqësues të rëndësishëm të tregut të punës. Rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe në gamën e lëndëve me zgjedhje që ofrohen.</p> <p>Duke qenë se edhe vetë studentët që ndjekin studimet në këtë program janë të punësuar, mendimi i tyre ka një rëndësi të madhe në këtë drejtim.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Gjatë hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit janë mbajtur parasysh objektivat kombëtare të zhvillimit. Në qendër është kontributi për formimin demokratik qytetar të studentëve, të</p>

	aftë për punë, në shërbim të shoqërisë së të ardhmes, ekonomisë së dijes dhe informacionit.
<b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Programi ofrohet me 120 kredite.  Punimi i diplomës vlerësohet me 36 kredite. Kohëzgjatja normale e programit është 2 vite akademike.
<b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET-it. Studentët në fillim të secilit semestër pajisen me të gjithë silabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar.  Programet e studimit, kurrikula, objektivat formuese dhe mundësitë e punësimit, publikohen në faqen zyrtare. Gjithashtu, studentëve u jepet informacion dhe këshillim nga stafi i trajnuar, para regjistrimit, gjatë javës së orientimit dhe këshillimit të karrierës.
<b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	
<b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Dokumenti për punimin e diplomës, pjesë e Broshurës së Dokumenteve UET, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplomë, miratimi i temës dhe pedagogut udhëheqës nga Departamenti, procesi i shkrimit të tezës, kalendari i seancave metodologjike, e deri tek formatimi konkret i punimit, dorëzimi dhe mbrojtja.
<b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>Përmbushen kryesisht standardet mbi misionin dhe objektivin e programit të studimit, përmbajtjen e programit, organizimin e vitit mësimor, semestrat, planet mësimore me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse.</p> <p>Programet mbajnë parasysh politikat kombëtare të zhvillimit dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, për të lehtësuar mobilitetin e studentëve. Konstatohet një ndarje e balancuar e ngarkesës mësimore nëpër semestra dhe nga njëri vit në tjetrin.</p> <p>Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Çdo fillim semestri atyre u vihet në dispozicion program i lëndëve që ofrohen (syllabuset). Këto programe u dërgohen elektronikisht nga koordinatoresha e departamentit, si dhe gjenden të printuara në librarinë e universitetit.</p>	

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Programi i studimit organizohet në 6 kategori disiplinash: 1. Kategoria A: Disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë 2. Kategoria B: Disiplina të formimit karakterizues të programit 3. Kategoria C: Disiplina të ngjashme dhe/ose integruese 4. Kategoria D: Disiplina të zgjedhura 5. Kategoria E: Veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësi kompjuterike, praktika 6. Kategoria F: Përgatitja e tezës së diplomës

Oftohen të ashtuquajturat “Honors course”, si pjesë e lëndëve të kategorive C dhe D. Këto propozohen dhe drejtohen nga pedagogë me grada dhe tituj të Universitetit. Metodologjia e mësimdhënies dhe mënyra e kontrollit të njohurive i përgjigjet natyrës teorike/praktike të lëndës Për cikle leksionesh/module brenda lëndëve të kategorive A dhe B, ftohen edhe ekspertë, profesorë të shquar të fushës.

Ndarja sipas veprimtarive mësimore jepet ne Tabelën 11

Një përmbushje e mirë e standardeve të brendshme vrojtohet edhe në lidhje me cilësinë e organizimit të lëndëve, përzgjedhjes së përshtatshme të literaturës (në gjuhë të huaj dhe shqipe), si dhe mjeteve e metodave të larmishme didaktike të përdorura gjatë leksioneve dhe seminareve. Cilësia e mësimdhënies lidhet ngushtë edhe me fushën e ekspertizës apo interesave kërkimore shkencore të pedagogëve, të cilat janë pasqyruar në artikuj e botime të tjera shkencore, workshope, konferenca e seminare, etj.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet janë (Tabela 12):

• Leksione	336 orë
• Seminare	168 orë
• Ushtrime	216 orë
• Praktikë profesionale	255 orë
• Punim Diplome	40 orë

#### Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive respektonin modelin e përzgjedhur dhe të afishuar në rregulloren e programit të studimit.

#### Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët në ballafaqimin që organizuam me ta dëshmuar se ishin të angazhuar në aktivitetet e njësisë së strukturës didaktike.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Për ndjekjen e programeve të studimit Master i Shkencave, UET-i pranon për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:

1. Studenti duhet të zotërojë së paku një diplomë të nivelit të parë (Bachelor) ose një diplomë tjetër të fituar jashtë vendit e të vlerësuar ekuivalente me të. Kur diploma e fituar nga studimet në ciklin e parë është në të njëjtën fushë studimi, studenti regjistrohet pa plotësim të njohurive formuese (pa debi formimi). Nëse diploma e ciklit të parë është në një fushë tjetër të ngjashme ose të përafërt, me ngjashmëri të programit në masën jo më pak se 2/3-tat, studenti regjistrohet me debi formimi deri në 60 ECTS.
2. Studenti duhet të plotësojë kriteret e vendosura nga Këshilli i Fakultetit.
3. Studenti duhet të dorëzojë dokumentacionin e plotë të dosjes së aplikimit që kërkohet nga universiteti.
4. Studenti duhet të posedojë një diplomë të një prej pesë gjuhëve të huaja të kërkuara nga Ministria, që në hyrje të studimeve në programin Master i Shkencave.
5. Studenti duhet të kryejë pagesën e tarifës së regjistrimit, sipas kushteve dhe përcaktimit të kontratës mes tij dhe institucionit.

Aplikimet shqyrtohen nga Departamenti Përgjegjës për programin e studimit, i cili harton listën e kandidatëve të pranuar dhe ia kalon për miratim Dekanit të Fakultetit. Në këtë fazë, Koordinatorja e Departamentit i komunikon secilit kandidat vendimin e pranimit, të mospranimit ose të përfshirjes në listën pritëse. Kandidati që nuk është përzgjedhur mund t'i drejtojë ankesë Dekanit brenda dy ditëve nga dalja e vendimit. Dekani, nëse e sheh të drejtë, propozon ngritjen e një Komisioni Rivlerësimi, vendimi i të cilit është i formës së prerë. Kandidati që nuk ka fituar mund të aplikojë përsëri vitin e ardhshëm. Lista përfundimtare e studentëve të pranuar shpallet jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Afati normal i studimeve për këtë program studimi është 2 (dy) vite akademike. Afati maksimal i përfundimit të studimeve është 4 (katër) vjet. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar marrëdhënia mes Universitetit dhe Studentit rinegociohet. Kur studenti ka ndërprerë studimet për një periudhë më të gjatë se 3 (tre) vjet, Këshilli i Fakultetit mund të kryejë verifikimin e vjetërsisë së njohurive të tij dhe rivlerëson kreditet e fituara nga studenti. Studenti i cili nuk arrin të marrë asnjë provim brenda 2 (dy) viteve akademike rresht, humbet të drejtën e vazhdimit të studimeve. Në programin e masterit të shkencave është si kusht i domosdoshëm dhe praktika profesionale e studentëve e cila organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i Departamentit, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Praktikave. Studenti i cili nuk shlyen praktikën profesionale nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën.

UET-i në kuadër të Shoqatës Alumni, vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, në mënyrë periodike mban kontakte të vazhdueshme me ish-studentë të cilët kanë kryer një cikël studimesh pranë UET-s ku qëllimi i saj është jo vetëm ndarja e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës. Qëllimi i ALUMNI është të ndihmojë në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë dallim të gjithë studentët dhe të diplomuarit e UET të identifikojnë dhe të përmbushin qëllimet e tyre të karrierës. Nëpërmjet eksperiencës si studentë, UET i ndihmon studentët të kuptojnë kush ata janë dhe do të jenë si profesionistë të ardhshëm si dhe si të

aplikojnë njohuritë e tyre akademike dhe aftësitë e punësimit në praktikë. Duke ofruar burime, kontakte, programe të kuptueshme, këshillim karriere, mundësi intershipi dhe punësimi Universiteti European i Tiranës mundëson edukimin e studentëve dhe të sapodiplomuarve se si të marrin vendime për karrierën, të zhvillohen profesionalisht dhe të arrijnë qëllimet e jetës akademike dhe profesionale. Rëndësi të veçantë në identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave të studentëve ka përfshirja e ishstudentëve tanë në aktivitetet e mëposhtme:

Panairin e Punës, duke iu ofruar studentëve aktual një mundësi për të kontaktuar drejtpërdrejt me përfaqësuesit e të paktën 52 kompanive të ndryshme në vend. Nëpërmjet programit 250+ u sigurohet studentëve dhe Shoqatës ALUMNI një sërë mundësish për të mësuar dhe për të ndërvepruar me punëdhënës duke siguruar kontakte me industrinë dhe organizata të ndryshme. Nga takimi që u zhvillua me studentët e programit Master i Shkencave "Komunikim - Marrëdhënie Publike" rezultoi se ata nuk kishin një informacion të qartë mbi këtë program.

Në Bordet e punës, si ura lidhëse dhe pika e kontaktit midis praktikës profesionale, tregut të punës dhe internshipeve, anëtarët e shoqatës Alumni ftohen të jenë pjesë aktive dhe e pandashme në këtë proces duke reflektuar mbi programet akademike dhe përputhjen e tyre me tregun e punës përmes sugjerimeve praktike duke rritur në këtë mënyrë cilësinë e mësimdhënies e mësimnxënies të studentët tanë ndër vite.

Çmimi i Karrierës, është një traditë në UET. Të gjithë ish studentët që pasi kanë përfunduar studimet kanë arritur një pozicion të mirë pune dhe kanë patur arritje në karrierat e tyre profesionale, vlerësohen me këtë çmim, që synon të promovojë arritjet e ish studentëve dhe të shërbejë si shembull për të gjithë ata që do të mbarojnë studimet në UET.

ALUMNI International, është takimi i përvitshëm i studentëve të UET që studiojnë në universitetet më të mira në botë. Follow up-i i përvitshëm për kontakte për vendet e punës, ngritja e database i kontakteve dhe qëndrimi në kontakt me ta, aktivitete të cilat kanë në fokus rritjen e cilësisë dhe shërbimeve ndaj studentëve dhe universitetit në tërësi. Identifikimin dhe kontaktimi i sa më shumë studentëve Alumni, me qëllim pasqyrimin sa më real të të dhënave të tyre është realizuar duke ndërthurur metoda sasiore të mbledhjes së të dhënave si më poshtë vijon:

- Filtrimi i listave të studentëve të vëna në dispozicion nga zyra e Arkiv-Protokollit dhe Statistikës;
- Identifikimi dhe mbledhja e të dhënave nga plotësimet e formularëve të UET-Alumni-t pas tërheqjes së vërtetimeve të uniformave të diplomimit;
- Kontaktime të drejtpërdrejta me telefonata të personalizuar;
- E-maile studentëve të cilët hezitonin të përgjigjeshin në telefoni, nuk kishin numër kontaktit ose kontakti i tyre ishte jashtë shërbimit;
- Identifikimi i ish-studentëve përmes stafit që punon në UET, duke kontaktuar rrjetin e tyre të kontakteve, etj.

Të gjithë të kontaktuarit janë informuar mbi qëllimin e administrimit e mbledhjes së të dhënave mbi statusin e punësimit dhe mundësitë e mbështetjes nga universiteti. Është tentuar të mblidhen informacione sa më të detajuara lidhur me statusin e punësimit të ish-studentëve, pozicionin si dhe institucionin në të cilin ata angazhoheshin.

Gjatë takimeve që u zhvilluan në kuadër të vlerësimit të këtij programi u informuam se Zyra e Kujdesit ndaj Studentit përballet me fenomenin e përgjithshëm për një shkallë të ulët të marrjes përgjigje nga të diplomuarit, për të marrë informacionin për statusin e punësimit të tyre. Niveli i mospërgjigjes, sipas këtij informacioni, ka ardhur në rënie, nga rreth 68% në vitin 2011-2012 në rreth 41% e të gjithë të diplomuarve në nivel Fakulteti. Nevojitet që ky

tregues të përmirësohet në mënyrë që të dhënat e generuara të jenë përfaqësuese dhe të mund të kenë vlerë për të kuptuar shkallën e punësimit të studentëve.

Gjatë kontrollit të regjistrave u gjetën studentë pa numra matricullimi:

- Në listën e studentëve të regjistruar në vitin 2015-2016 14 studentë
- Në listën e studentëve të regjistruar në vitin 2016-2017 10 studentë
- Në listën e studentëve të regjistruar në vitin 2017-2018 të gjithë st.

Pas verifikimit rezultonin këto arsye:

1. Mospajisja me kartonin e diplomës në Bsc (vonesa në lëshim, debite financiare)
2. Ekzistenca e emrit në dy programe studimi njëkohësisht
3. Vonesa të AKP (për vitin aktual)

U deklarua se problematikat po zgjidhen rast pas rasti.

#### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

##### **Procedurat e pranimit të studentëve**

Procedurat e pranimit të studentëve në këtë Program, bazuar në dokumentacionin që shqyrtoam, apo sipas prezantimeve që na bënë në Departament dhe në Sekretarinë mësimore, ishin në përputhje me standardet e miratuara nga MAS dhe sipas akteve rregullative të UET. (siç janë përshkruar dhe në informacion e mësipërm).

Mënyra e vlerësimit të studentëve paraqitet me pikë, notë e germë (Tabela 13).

Ndarja e formave të kontrollit të njohurive jepet në Tabelën 14

##### **Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Për pranimin e studentëve respektoheshin rigorozisht kërkesat në dokumentacion dhe numër, por në këto kërkesa nuk përfshihej ndonjë kriter mesatareje për regjistrim. Në departament argumentonin se numri i reduktuar i koutave ishte në vetvete tregues për cilësinë e pranimeve, por jo që të kishte ndonjë kufi (stekë) për nivel të domosdoshmëm që kandidati të mund të pranohej.

##### **Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare, studentët e diplomuar (Tabela 15)**

Viti akademik	Programi/profli	Studentë 2011 -2018 të rregjistruar per here te pare	Studentë transferuar sipas viteve		Totali studentë te transferuar	Totali per profilet	Totali per programin	Studentë të diplomuar
			Viti I	Viti II				
2011 - 2012	Marrëdhënie publike	19			I+II	A+B+C	26	9

	Studime dhe teoritë e komunikimit	7				7		
2012 - 2013	Marrëdhënie publike	21				21	23	15
	Studime dhe teoritë e komunikimit	2				2		
2013 - 2014	Marrëdhënie publike	22		5	5	27	29	20
	Studime dhe teoritë e komunikimit	1		1	1	2		
2014 - 2015	Marrëdhënie publike	23		1	1	24	25	17
	Studime dhe teoritë e komunikimit	1				1		
2015 - 2016	Marrëdhënie publike	33	1	7	8	41	41	27
	Studime dhe teoritë e komunikimit							
2016 - 2017	Marrëdhënie publike	21		3	3	24	24	-
	Studime dhe teoritë e komunikimit							
2017 - 2018	Marrëdhënie publike	21		5	5	26	26	-
	Studime dhe teoritë e komunikimit							
Totali		171	1	22	23	194	194	88

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse).** Cilësia në hyrje e dalje e studentëve (Nota Mesatare)

Të dhënat jepen në Tabelën 16 dhe 17 në Aneks

Nga verifikimi të dhënat përputheshin me regjistrat e Sekretarisë së Qëndrore

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend, Të dhëna për punësimin e studentëve, Numri total të diplomuarve, Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën), Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)**

Në pjesën më të madhe studentët ishin të punësuar në përputhje me diplomimin e tyre dhe një pjesë të diplomuarish vinin nga ambiente pune që kërkonin një kualifikim të mëtejshëm.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të</p>	<p>Studentët të cilët ndjekin studimet Master i Shkencave zotërojnë një diplomë bachelor e cila ka 180 kredite ECTS të grumbulluara.</p> <p>Të gjithë ata që regjistrohen në këtë program kanë plotësuar fillimisht kriteret e përcaktuara nga institucioni</p> <p>Bazuar në udhëzimet e MAS, studentët janë të pajisur me një diplomë të gjuhës së huaj në hyrje të vitit akademik. Pa këtë document ata nuk mund të fillojnë studimet në këtë program.</p> <p>Në vijimësi UET-i ka bërë përmirësime në aspektin e</p>

studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;

**Kriteri 5** Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.

kritereve të pranimit të studentëve, në favor të rritjes së cilësisë së tyre.

**Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.**

**Kriteri 1** Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;

**Kriteri 3** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.

UET-i ka një strukturë stabël për të informuar studentët rreth mundësive të tyre për punësim, jo vetëm pas përfundimit të studimeve, por edhe gjatë procesit, ku ata herë pas here njoftohen për aplikime punësimi, nga ana e institucionit.

Studentët marrin informacion rreth programeve të studimit brenda universitetit si dhe për vlefshmërinë e diplomës së tyre jo vetëm brenda Shqipërisë por edhe jashtë saj.

UET-i fokusohet te procesi i këshillimit të karrierës për studentët, duke realizuar aktivitete për këtë gjë ose çdo student i interesuar mund të shkojë tek Zyra e Këshillimit të Karrierës për t'u informuar për aspekte që ka interes.

**Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

**Kriteri 1** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

**Kriteri 2** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;

**Kriteri 3** Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

Zyra e Protokollit, Arkivit dhe Statistikave në UET është përgjegjëse për përpunimin e statistikave në nivel institucioni, duke u koordinuar me Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Financës.

UET-i mban dhënat statistikore mbi numrin e të diplomuarve në programet e studimit që kanë përfunduar, sa studentë janë regjistruar, sa janë diplomuar në kohë dhe sa me vonesë, sa studentë janë larguar dhe i kanë lënë përgjysëm studimet.

Institucioni disponon të dhëna statistikore për ecurinë akademike të studentëve që nga hyrja e tyre në këtë universitet deri në aktin e diplomimit të tyre.

**Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

**Kriteri 1** Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas

Në institucion ka një bazë të dhënash, e aktualizuar, për të gjithë studentët të cilët janë të punësuar, si



<p>përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>dhe për pozicionet që ata kanë në institucionet ku punojnë.</p> <p>Institucioni mban po ashtu rekorde mbi numrin e studentëve të cilët vazhdojnë studimet në universitetet e huaja.</p>
---	--

**Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>UET-i informon studentët mbi programet e studimeve në mënyrë të detajuar. Java orientuese, që zhvillohet në fillim të vitit akademik shërben për të qartësuar studentët në lidhje me programin e studimit.</p> <p>Gjatë vitit akademik ata kanë informacion të vazhdueshëm për programin e tyre të studimit.</p> <p>Me përdorimin e sistemit LMS, studentët kanë akses në çdo orë për t'u informuar për rezultate e vlerësimit të tyre. Përgjegjësi i modulit është i gatshëm për të diskutuar rreth vlerësimit të studentit nëse ky i fundit dëshiron të dijë më shumë.</p>
---	---

**Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik.</p> <p>Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p>
---	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Standardet për procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e tyre, informimi mbi aspekte të realizimit të programit master i shkencave studentëve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar dhe orientimin për në tregun e punës plotësohet kryesisht në masterin e shkencave "Komunikim - Marrëdhënie Publike".

Institucioni tregon kujdes nga momenti i regjistrimit të studentit e deri në diplomimin e tij.

Krahas këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes tutoriatit dhe këshillimit akademik, studentin mund t'i drejtohet edhe Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyrës së Karrierës dhe Praktikave, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin

mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë UET-it.

Në takimet që zhvilluam përfaqësues të UET-it na u prezantua dhe programi 250+, i cili u siguron studentëve dhe Shoqatës ALUMNI një sërë mundësish për të mësuar dhe për të ndërvepruar me punëdhënës duke siguruar kontakte me industrinë dhe organizata të ndryshme. Por nga takimi që u zhvillua me studentët e programit Master i Shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike” rezultoi se ata nuk kishin një informacion të qartë mbi këtë program.

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Në UET, kërkimi shkencor, inovacioni dhe mobiliteti i stafit janë një gur themeli dhe pjesë kryesore e strategjisë së zhvillimit institucional. Për të ndërmarrë kërkim shkencor në nivelin më të lartë dhe të orientuar drejt politikave publike, Universiteti European i Tiranës bazohet në gamën e gjerë të ekspertizës që ka në shkencat sociale, humane, ekonomike dhe teknologjitë e informacionit, edukimit, dhe komunikimit. Stafi akademik dhe drejtues shpreh vullnetin për të ndërmarrë hapa proaktivë në forcuarimin e pikave të forta dhe për të adresuar çdo kufizim të mundshëm. Fokus të veçantë ka në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për mobilitetet e stafit dhe forcimin e portofolit të kërkimit.

UET ka konsoliduar revistat shkencore nga 5 në 2 për të maksimizuar përdorimin e burimeve akademike dhe për të prodhuar kërkime më të mira në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në mënyrë të veçantë, UET publikon dy revista shkencore ndërkombëtare: Economicus (ISSN: 22236295) dhe Polis (ISSN: 2223-8174). Economicus publikon kërkime në fushën e ekonomisë, zhvillimit dhe IT, ndërsa Polis publikon kërkime në fushën e shkencave humane dhe shoqërore. Revistat publikojnë artikuj vetëm në gjuhën angleze, mbështeten në një proces ‘double blind peer review’ dhe do të kenë faqet e internetit të dedikuara (do të finalizohen deri në shtator 2017) ku do të publikojnë artikujt pa pagesë.

UET-i siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim. Si pjesë e ristrukturimit të revistave shkencore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të produktit të kërkimit shkencor, UET ofron trajnime për botimin dhe kryerjen e kërkimeve në grup për stafin akademik. Trajnimi është i organizuar në seminare tre-ditore që ofrohen në fund dhe fillim të kalendarit akademik.

UET siguron mbështetje financiare për kërkimin shkencor.

Në institucion raportojnë se për kërkimin shkencor akordohet një fond prej 500,000 euro në vit. Kjo ka inkurajuar akademikët në universitet që të hulumtojnë dhe të publikojnë dhe në bazë të performancës marrin grantet e tyre kërkimore. Lidhja e shpërblimit financiar me arritje të matshme akademike është një mekanizëm i përshtatshëm për të kontrolluar dhe inkurajuar veprimtarinë shkencore dhe botimet. Në këtë mënyrë universiteti shmang shpërdorimin e burimeve, shpërblen ata që janë më aktivë dhe produktivë në kërkim, dhe krijon një mjedis ku kërkimi është pjesë integrale e jetës universitare.

Departamentet. Çdo departament dhe Fakultet i dorëzon në fillim të vitit akademik Zv/Rektorit për Kërkim Shkencor dhe Metodologjinë kalendarin e aktiviteteve shkencore (konferenca/workshop-e, kolokiume shkencore etj). Po ashtu, mbledhja e fundit e muajit (mbledhja javore) në çdo departament ka për tematikë kërkimin shkencor brenda departamentit, zhvillime të reja në fushën e botimeve, promovimin dhe pjesëmarrjen e stafit në konferenca.

#### Mobilitetet Akadematike

UET është i angazhuar të ofrojë gamën më të gjerë të mundshme të mobiliteteve për studentët, stafin dhe kërkuesit si një nga mjetet më të sukseshme për avancimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e standardit të produktit të kërkimit shkencor. Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare në UET ka rol të rëndësishëm në vendosjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shumë universitete të BE. UET ofron të gjitha lehtësimet e nevojshme administrative, siç është leja e paguar dhe zëvendësimi i orëve të mësim-dhënies, në mënyrë që personeli akademik dhe stafi të mund të angazhohen në mobilitete sa më lehtë që të jetë e mundur.

Të dhëna për aktivitete shkencore dhe përfshirjen e studentëve në to jepen në Tabelën 18.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Të dhëna për kërkimin shkencor**

Duke filluar nga viti akademik 2010-2011, UET ka një pozicion të dedikuar posaçërisht Kërkimit Shkencor, që është posti i Zv/Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë. Posti synon koordinimin e gjithë hallkave të kërkimit shkencor që nga fakultetet/departamentit, Zyra Doktorale dhe pasurimi i përhershëm i bibliotekës, si dhe ruajtja e standardeve të botimit në revistat shkencore të UET-it. Nën drejtimin e Zv/Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe metodologjinë UET është i angazhuar të ndërmarrë kërkim të avancuar shkencor për të prodhuar njohuri të vlefshme për botën akademike dhe për të mundësuar përparimin e shoqërisë shqiptare.

##### **Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL**

Personeli akademik efektiv, siç tregohet edhe në tabelat e mëposhtme ka hartuar dhe ka përpunuar tekstet bazë që përdoren sot në fushat e studimit që aplikohen në këto dy programe.

##### **Numri i projekteve kërkimore të fituara**

Për periudhën 2015-2017 UET ka zbatuar 12 Marrëveshje Ndër-institucionale brenda Erasmus + ICM si dhe menaxhimin e projektit SIGMA Agile Tempus. Këto projekte përqëndrohen në shkëmbimin e stafit dhe studentëve, dhe synojnë të mbledhin praktikat më të mira europiane dhe t'i zbatojnë ato në UET kur është e mundur. Shkëmbimet bëhen në nivel të studentëve, personelit administrativ si dhe stafit akademik. Lëvizshmëria e studentëve të doktoraturës dhe stafit akademik përfshin hulumtime në fusha specifike. Në mënyrë të veçantë, gjatë periudhës 2015-2017 UET ka qenë institucioni dërgues i 51 anëtarëve të stafit, 30 prej të cilëve ishin mobilitete për qëllime kërkimore / mësimore. Për të njëjtën periudhë UET ka pritur 18 punonjës nga universitetet e BE-së, 15 prej të cilëve kanë kryer aktivitete hulumtuese / mësimore.

- Numri i projekteve të zbatuara, Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL, Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor, Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor**

UET i ka kushtuar rëndësi të veçantë mobilitetit të studentëve. UET ka pritur 13 studentë të huaj, nga të cilët 6 kërkues doktorantë dhe 1 student MA që ka kryer kërkime për tezën e tij. Sa u përket studentëve që shkojnë nga UET ne universitete të BE, UET ka qenë institucioni dërgues i 38 studentëve, nga të cilët 6 studentë të doktoraturës. Aktualisht, UET ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me CEU-Budapest dhe është bërë pjesë e Programit CEU të Ndihmës Globale. Duke filluar nga shtatori 2017, UET do të jetë institucioni pritës për lektorët dhe kandidatët e avancuar të doktoratës të CEU, të cilët do të japin mësim dhe ndërmarrin kërkim shkencor në UET. Gjithashtu, për vitin akademik 2017-2018 UET ka aplikuar për 31 marrëveshje Erasmus + për të mundësuar mobilitete për 207 studentë dhe kërkues.

Në takimin me studentët e vitit të parë dhe të dytë master i shkencave në "Komunikim - Marrëdhënie Publike" evidentuam 3 raste të studentëve që ishin përfitues nga Erasmus +.

Te dhenat për projektet/aktivitetet jepen në Tabelat 18, 19, 20 dhe 21

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm që angazhohet në këtë program master i shkencave ka botuar në revistën Polis, organ i UET-it. Gjithashtu ata kanë botuar artikuj dhe në revista të specializuara brenda dhe jashtë vendit, si dhe janë autorë veprash studimore me kontribut në këtë fushë.</p> <p>Departamenti që mbulon këtë program master i shkencave është përfshirë në organizmin e konferencës ndërkombëtare Studime Shqiptare (prill 2015, prill 2016, prill 2017), si dhe është organizues i konferencës kombëtare Kultura dhe Letërsia zhvilluar në kuadrin e Ditëve letrare Razëm (maj 2017). Personeli akademik merr pjesë dhe në konferenca shkencore si brenda dhe jashtë vendit.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	N/A
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtjshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>UET organizon periodikisht eventin Staff Development Day (Ditën e Zhvillimit të Stafit), me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet, metodologjinë dhe TIK.</p> <p>Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit është e angazhuar për të përfshirë stafin akademik në projekte kërkimore të lancuara nën programin FP7, në Konsorciume me partnerë ndërkombëtarë.</p> <p>Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET përgatit dhe shpërndan tek personeli akademik informacion në lidhje me mundësi aplikimi për programe kërkimore, trajnime dhe kualifikime si dhe ofron konsulencë për zhvillimin e aplikimeve.</p> <p>UET nxit kualifikimin e mëtjshëm të personelit duke mbështetur pjesëmarrjen në aktivitete shkencore ndërkombëtare. Ai jep grante për zhvillimin e projekteve kërkimore. Pedagogët që kanë 5 vite në UET gëzojnë të drejtën e simestrit sebatik të paguar.</p>
--	--

**Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Secila njësi bazë në UET ka në dispozicion axhendën kërkimore të secilit pedagog në harkun e 5 viteve, si dhe një bazë të plotë të dhënash të punës kërkimore, botimeve dhe pjesëmarrjeve me kumtesë në konferenca brenda dhe jashtë vendit të stafit në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET disponon një bazë të dhënash (Excel spreadsheet) me detaje të projekteve kërkimore, zhvillimi, ndërtim kapacitetesh etj., në të cilat ka marrë pjesë ose është aktualisht i përfshirë personeli akademik, si dhe me detaje të projekteve në aplikim/të ardhshme. Baza e të dhënave përmban: detaje për projektin; për donatorin; për partnerët; për personelin akademik të përfshirë; etj.</p>
---	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Ky program studimi e plotëson standardin për kërkimin shkencor, në politikat që ndiqen në këtë drejtim, botimet nga anëtarët e stafit akademik, pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia dhe lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Anëtarë të stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi janë me reputacion në fushën e tyre të kërkimit dhe studimit. UET-i ka hapa konkretë në drejtim të organizimit dhe bashkërendimit të punës kërkimore shkencore të personelit akademik, në rang departamenti e më gjerë. Çdo departament planifikon çdo fillim viti veprimtaritë shkencore që do të organizojë, i vetëm ose në bashkëpunim me departamente të tjera, ose universitete partnere. Revistat shkencore Polis ofron një hapësirë të mirë për publikimin e rezultateve të punës kërkimore të personelit akademik, sigurisht duke respektuar kriteret e vendosura nga bordi editorial. Zyra e Projekteve shërben si katalizator për të indentifikuar projekte dhe

koordinuar përfshirjen e pedagogëve në projekte që përputhen me interesat dhe ekspertizën e tyre shkencore.

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

UET-i ka ndërtuar dhe vijon të ndërtojë ura bashkëpunimi me institucione të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, sektorit publik dhe atij privat me qëllim krijimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik. Në mënyrë të veçantë bashkëpunon me Universitetin e Aston-it në Britaninë e Madhe në kuadër të programeve të Shkollës Doktorale. Ky bashkëpunim nënkupton shkëmbimin e programeve, pedagogëve, studentëve dhe në të ardhmen synon formimin dhe udhëheqjen e përbashkët të doktoraturave me profesorë të këtij universiteti. UET-i bashkëpunon ngushtë edhe me institucione të tjera të arsimit të lartë në Europën Juglindore dhe Bashkimin Europian në kuadër të programeve Tempus, Jean Monnet, Erasmus+, si dhe me institucione të tjera në kuadër të programeve mbështetëse për kërkimin nga donatorë ndërkombëtar dhe lokal si Regional Research Promotion Programme; NUFFIC, Assist Impact/USAID, Fondacioni Shoqëria e Hapur, American-Albanian Development Fund, Swiss Development Cooperation, Agjencitë e UN, etj.

Një nga iniciativat më të rëndësishme të këtij institucioni për vitin 2014-2015 ishte ndërtimi i rrjetit 'Next Europe', nën kujdesin e Zyrës së Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim. Ky Rrjet ka synuar dhe vijon të synojë trajtimin me përparësi të problematikës së demokratizimit, zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe institucional të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke u fokusuar tek parametrat e modernizimit dhe europianizimit të tyre, si në planin politik ashtu edhe ekonomik e social. Rrjeti Next Europe iniciohet nga Universiteti Europian i Tiranës dhe përbëhet nga universitetet lider në Ballkanin Perëndimor (Universiteti i Beogradit, Sarajevës, Podgorica, UGD, Universiteti i Europës Juglindore në Maqedoni), si edhe nga qendra kërkimore në Europë (si LSE Research on South East Europe, Sciences Po, European University Institute, American University Bulgaria, Center for South East European Studies Graz, UCL School of Slavonic and East European Studies), të cilat merren me studime e kërkime për këtë rajon dhe kanë fushë.

Mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve realizohet në kuadër të:

- projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit Europian;
- të projekteve kërkimore dhe rrjetëzimit si COST dhe Horizon2020 të Komisionit Europian;
- Visegrad University Fund në bazë të marrëveshjeve të veçanta me institucione të tjera në kuadër të thirrjeve të projekteve kërkimore bilaterale si Shqipëri-Austri dhe Shqipëri-Turqi etj (aplikuar nga AKTI);

- sipas aplikimeve individuale të stafit për të kryer periudha kërkimore në universitete të tjera jashtë.

UET-i ka ndërtuar mekanizma për ndërlidhjen me sferën e biznesit, tregun e punës si edhe aktorë të tjerë në shoqëri. UET ka ndërtuar Bordet e Punës pranë secilit departament në fakultetet përkatëse, si edhe organizon njëherë në vit një Panair Pune, në muajin maj, me pjesëmarrje të punëdhënësve kryesore në vend. Rrjeti UET Alumni ndihmon për gjurmimin e studentëve në tregun e punës dhe rilidhjen e tyre me universitetin dhe brezat e rinj.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabelat 22 dhe 23)**

- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
- Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

UET-i është pjesë e Rrjeteve Ndërkombëtare të Universiteteve si SEUN-Rrjet partnerësh mbi startup, sipërmarrjen rinore dhe inovacionin (Spanjë); UNIMED- Rrjet universitetesh mesdhetare me qëllim shkëmbimin e stafit dhe studentëve (Itali); FEDE-Rrjet europian universitetesh me qëllim kërkimin shkencor (Portugali). Ai ka marrëveshje institucionale për kërkimin shkencor me La Sapienza University of Rome, Itali, me fokus seminare doktorale si dhe Central European University, Budapest, me fokus programin "Global Teaching Fellowship" për shkëmbim stafi akademik.

Gjatë vitit 2015-2017 janë kryer 107 mobiliteti staf dhe studentë nga UET drejt Universiteteve partnere. 18 staf dhe 13 studentë kanë ardhë në UET përmes bursave Erasmus + gjatw 2015-2017. Në takimin me studentët e vitit të parë dhe të dytë master i shkencave në "Komunikim - Marrëdhënie Publike" evidentuam 3 raste konkrete të studentëve që ishin përfitues nga Erasmus +.

##### **Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:**

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

UET-i ka ndërtuar mekanizma për ndërlidhjen me sferën e biznesit, tregun e punës si edhe aktorë të tjerë në shoqëri. UET ka ndërtuar Bordet e Punës pranë secilit departament në fakultetet përkatëse, si edhe organizon njëherë në vit një Panair Pune, në muajin maj, me pjesëmarrje të punëdhënësve kryesore në vend. Rrjeti UET Alumni ndihmon për gjurmimin e studentëve në tregun e punës dhe rilidhjen e tyre me universitetin dhe brezat e rinj.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>UET ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>Programi 250+ është krijuar pikërisht për të rritur bashkëpunimin e UET dhe të këtij programi studimi me kompani të llojeve të ndryshme. Ky program synon që nëpërmjet bashkëpunimit me këto kompani të bëhet i mundur integrimi i studentëve tanë në internshipe dhe në punësimin e tyre, synon rritjen e njohurive dhe aftësisimit profesional, shkencor e praktik të studentëve që ndjekin këtë program studimi duke patur këto kompani prioritare për të dërguar studentët në praktika profesionale dhe në përfshirjen e drejtuesve të këtyre kompanive në leksione të hapura në programet Master duke përçuar praktikën dhe eksperiencën e tyre tek studentët. Siç e kemi përmendur më lart, nga takimi që u zhvillua me studentët e programit Master i Shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike” rezultoi se ata nuk kishin një informacion të qartë mbi programin 250+.</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Personeli akademik përfshihet periodikisht në hartimin dhe rishikimin e programeve të studimit të departamentit. Të gjitha propozimet diskutohen paraprakisht në mbledhje departamenti, për të mbledhur mendimet e anëtarëve në lidhje me përmirësimet që gjykohen të nevojshme.</p> <p>Ndarja e detyrave në lidhje me procesin mësimor dhe mbarëvajtjen e zhvillimit të programit të studimit është e përcaktuar në aktet rregullatore të institucionit, të cilat janë të publikuara në Dokumentet UET dhe zbatimi i tyre monitorohet vazhdimisht. Kjo u jep mundësi anëtarëve të personelit të sqarojnë edhe ndonjë keqkuptim apo paqartësi që mund të lindë në lidhje me detyrat e përgjegjësitë e tyre, si edhe të përmirësojnë performancën e tyre.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p>	<p>UET ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe vendase dhe të huaja, kryesisht për shkëmbimin e stafit dhe studentëve, ashtu edhe me aktorët e biznesit për të rritur përputhshmërinë e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, dhe mundësinë e punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre.</p>



**Kriteri 2** Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

**Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Institucioni analizon ecurinë dhe rezultatet e këtyre bashkëpunimeve, duke u përpjekur të identifikojë dhe shfrytëzojë mënyra e mjete për të rritur nivelin dhe cilësinë e këtij bashkëpunimi dhe impaktin e tij në programet e studimit.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Standardet e bashkëpunimit me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik si dhe studentët, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës janë të plotësuara nga UET.

Institucioni mban lidhje të qëndrueshme me mjaft institucione të administratës publike dhe të komunitetit të biznesit dhe organizatave jofitimprurëse. Në kuadër të përfshirjes në projekte ndërkombëtare, stafi i departamentit ka pësuar ngritje cilësore akademike dhe profesionale duke sjellë në auditoret e UET metodikat më të fundit të mësimdhënies dhe debateve teorike. Bordi i Tregut të Punës, ku ftohen të marrin pjesë përfaqësues të shquar për arritje në fushën e programeve të studimit, ofrojnë konsulencë për të rritur përputhshmërinë e diplomave me tregun e punës, për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve si edhe për punësimin e ardhshëm të tyre.

UET zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to. Edhe periudha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon pikërisht me fundin e vitit akademik për të krijuar sa më shumë mundësi për studentët në prag diplomimi.

## **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

**Institucioni të punojë për punësimin me kohë të plotë të personelit të brendshëm dhe të mos lejojë dy punësimin me kohë të plotë.**

Ky rekomandim është plotësuar për programin master i shkencave “Komunikim - Marrëdhënie Publike”. Rregullimi me kontratë standard i angazhimit në UET nuk lejon punësimin me kohë të plotë të njëkohshëm dhe në këtë universitet edhe në një institucion tjetër. Një pjestar i stafit me kohë të plotë punësimi deklarimin për angazhimet e tjera jashtë institucionit e bën ose në momentin kur nënshkruan kontratën individuale, ose kur angazhimi fillon pas nënshkrimit të kontratës. Në rastin e dytë veprohet me deklaram duke plotësuar formularin G.I.10.3, që përfshin jo vetëm prezantimin e angazhimit jashtë institucionit, por dhe dhe miratimin nga Administratori.

**Të rishikohet profilizimi më i qartë i disa planeve mësimore si p.sh., te programi “MNP Shkenca Komunikimi”, “MND Marrëdhënie Ndërkombëtare”, etj.**

*Mendojmë se ky rekomandim është plotësuar.* Ka një proces profilizimi hierarkik, me pikënisje nga departamenti e duke vijuar në rang fakulteti e deri në rang universiteti, por dhe është sistematik, duke reflektuar në mënyrë të vazhdueshme propozime dhe nisma për përmirësimin e kurrikulës së programit. Nga dy profilet që ka ky program master i shkencave, procesi ka dhënë impakt tek “Marrëdhënie Publike”, një profil me dinamikë të qëndrueshme në aspektin e kërkesave që ka për t’a ndjekur nga ana e studentëve, të cilët nivelin e parë të studimeve e kanë kryer në UET ose në IAL të tjera. Kurse për “Studime dhe Teoritë e Komunikimit” situata është “standby”/ vendnumëro, pasi pavarësisht ofertës që ka Departamenti në tre vitet e fundit nuk ka pasur interesim nga studentët për t’a kryer ciklin e dytë master i shkencave në këtë profil. Mbetet të shikohet efekti pasi të bëhen ndryshime për tejkalimin e kësaj situatë.

**Të vazhdohet puna e nisur me Universitetet perëndimore, me të cilat janë lidhur marrëveshje dhe mundësisht, të shtohen kontaktet me universitet e tjera.**

*Në vlerësimin tonë ky rekomandim është plotësuar.* Programi Master i Shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike”, si pjesë ofertës së studimeve dhe procesit kërkimor shkencor në UET është përfitues dhe i projekteve të përbashkëta që ka ky universitet me institucione homologe, rrjete universitare, programe ndërkombëtare etj. Janë arritur rezultate konkrete nga procesi i mobilitetit të stafit akademik, si dhe të studentëve, në kuadër të zbatimit të projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit European; si dhe të projekteve kërkimore dhe rrjetëzimit si COST dhe Horizon2020 po të Komisionit European etj.

**Të shihet mundësia e aplikimit të kriterit të mesatares, mbase dhe ajo e përdorimit të gjuhës angleze, për studentët e diplomave DND, MNP e MND.**

*Në vlerësimin tonë ky rekomandim është plotësuar.* Për studentët që ndjekin aktualisht programin në vitin e parë dhe të dytë, nuk rezultoi se kishte ndonjë kriter mesatareje për rekrutimin e studentëve, dmth nuk kishte “stekë” kufizuese për ndjekësit e këtij programi master i shkencave. Por numri i kufizuar i studentëve, rreth 25 për secilin vit akademik,

përbënte për departamentin përkatës një kriter indirekt për cilësinë e pranimit në këtë program studimi, pasi bëhej përzgjedhje mes aplikuesve kur kishte raste që ato të ishin më të larta se kuota e caktuar.

Sa i takon nivelin e njohurive në gjuhën e huaj, kjo konsiderohet si e tejkaluar, pasi bazuar në përmirësimet e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, ka kriter strikt për gjuhën e huaj, për cilindo student aplikant në nivelin e dytë të studimeve dhe kjo zbatohet nga UET-i.

### **Të rritet më tej përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor.**

*Ky rekomandim është plotësuar.* Vetë procesi i ideimit dhe përgatitjes së punimit të diplomës, ndjekja e seancave metodologjike si dhe konsultimet me udhëheqësin deri në finalizimin e punimit mbetet në qendër të vëmendjes për secilin prej studentëve të vitit të dytë. Por disa nga studentët e programit master i shkencave ishin të përfshirë konkretisht dhe në projektet studimore shkencore të pedagogëve të departamentit me kontribute që ishin në përputhje me nivelin e njohurive dhe përgatitjes së tyre. Gjithashtu në program kishte dhe studentë që ishin përfitues nga përfshirja në projekte mobiliteti në kuadër të Erasmus+, apo në programe dhe projekte ku UET-i ishte partner.

## **II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

### **a. Pika të forta:**

1. Universiteti ka hartuar një strategji të qartë të kërkimit shkencor e cila është e integruar ndërkombëtarisht, por edhe e aplikueshme në kushtet e vendit tonë.
2. Personeli mësimdhënës ka kualifikimin e duhur për këtë nivel edukimi, disa syresh gëzojnë karrierë të rëndësishme akademike. Kujdes i është kushtuar edhe faktit që personeli mësimdhënës të harmonizojë përvoja dhe gjenerata të ndryshme akademike.
3. Shumë prej anëtarëve të stafit akademik janë figura dhe personalitete të njohura publike të cilët janë aktivë në mediat televizive dhe online.
4. Tregohet kujdes që literatura e përdorur gjatë programit mësimor të konvergojë me ecurinë e dijeve në këtë fushë në nivel ndërkombëtar. Për këtë është ruajtur koherenca e literaturës me atë që ofrojnë shtëpitë botuese më prestigjioze në botë (Oxford University Press, Cambridge University Press, Routledge, etj.).
5. Departamenti ka vendosur dhe mban kontakte të rregullta me akademikë dhe ekspertë të fushës jashtë institucionit, si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë. Ky është një aspekt tjetër i cili garanton që dija më e fundit që qarkullon në botë të jetë prezente edhe në UET.
6. Nga përfshirja dhe integrimi i UET-it me projekte e programe bashkëpunuese ndërkombëtare, sic është rasti konkret me Erasmus+, përfitues kanë qenë dhe studentët të programit Master i Shkencave "Komunikim - Marrëdhënie Publike".
7. Departamenti ka institucionalizuar kontaktet periodike me studentët duke i bërë pjesë të mbledhjeve ku debatohen çështje të programit mësimor dhe të mësimdhënies.

8. Për të ruajtur kontaktin intensiv pedagog-student si dhe për të ndjekur në progres ecurinë e përgatitjes së punimeve akademike të studentëve aplikohen me rigorozitet seancat metodologjike dhe këshillimi akademik.
9. Për të lehtësuar procesin e kalimit të studentëve nga auditori në tregun e punës UET organizon rregullisht panairët e punës; ndërsa Departamenti realizon takime periodike me studentët e diplomuar që janë modele suksese në tregun e punës dhe jetën publike.
10. Veprimtaria akademike dhe ajo administrative në UET kontrollohet nga rregulla të qarta e të sakta, të shprehura në Statutin e UET, Rregulloren Bazë të UET, Broshurën e Dokumenteve Themelore të UET, etj. Këto dokumente, janë të depozituara në sistemin informatik të UET dhe të disponueshme elektronikisht nga tërë personeli akademik, administrativ si dhe studentët.

**b. Pika të dobëta:**

1. Profili “Studime dhe Teoritë e Komunikimit” mbetet i pafrekuentuar. Në tre vitet e fundit nuk ka pasur interesim nga studentët për të ndjekur ciklin e dytë në këtë profil të Programit. Departamenti që e mbulon, Fakulteti, si dhe instancat akademike të UET duhet të reagojnë energjikisht për të aplikuar masa përmirësimi të planeve mësimore, të cilat janë objekt debati prej kohësh në rradhët e stafit akademik të fushës.
2. Për studentët me aftësi të kufizuar ka vend për përmirësim të strukturës universitare.
3. Në ambjentet e bollshme të Bibliotekës duhet të shtohet dhe një sistem monitorimi për të siguruar inventarin e hapur me libra e periodikë që janë në shërbim të studentëve. Për punonjësit e bibliotekës duhet të jetë detyrim bazë kryerja e Shkollës Kualifikuese të Bibliotekonomisë, pranë Bibliotekës Kombëtare, në favor të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe orientimit të përdoruesve në literaturë. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar edhe përdorimit më të gjerë të bibliotekave dixhitale.

**c. Mundësitë:**

1. Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun ka kapacitete për të organizuar ose bashkëorganizuar periodikisht konferenca apo simpoziume shkencore të fokusuara në tema dhe aspekte thelbësore mbi të cilat është ndërtuar kurrikula e dy niveleve të studimit për programin “Komunikim dhe Marrëdhënie Publike”.
2. Laboratori multimedial duhet të jetë më eficient dhe me infrastrukturë të modernizuar, për t’i dhënë mundësi dhe mbështetje reale studentëve të programit të studimit master i shkencave në “Komunikim - Marrëdhënie Publike”, si dhe të tjerëve që ndjekin nivelin e parë dhe të dytë të studimeve në Departament për ideimin dhe realizimin e detyrave dhe praktikave në shërbim të programit mësimor.
3. Në kuadrin e politikave integruese të Shqipërisë në BE ekzistojnë të gjitha mundësitë që të rritet dhe të zgjerohet shkalla e bashkëpunimit si me institucionet analoge në Ballkan dhe përtej tij. Një gjë e tillë do të rrisë shkallën e konkurrimit të UET-it në plan rajonal dhe gjithëeuropian.
4. Duhet nxitur pjesëmarrja më aktive e studentëve aktivitet shkencore që organizon departamenti. Një gjë e tillë i shërben rritjes së përgjegjësisë dhe kontributit të tyre në fushën që studiojnë.

**d. Pengesat:**

1. Konkurrenca me IAL-të e tjera aq sa është pozitive për zhvillimin e këtij programi mësimor, po aq është edhe pengesë pasi rrit konkurrencën në treg, si për sa i përket prurjeve të studentëve, ashtu edhe në stabilitetin e stafit akademik.
2. Edhe pse ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Arsimin e Lartë, ende vihen re praktika dhe procedura diskriminuese, të cilat paragjykojnë dhe pengojnë sektorin privat të arsimit.
3. Plagjiatura në provime dhe në hartimin e punimeve akademike nga studentët ende mbetet një nga pengesat potenciale lidhur me formimin akademik të studentëve.
4. Problemet e arsimit në Shqipëri që mbarten nga një nivel në tjetrin reflektohen edhe në ciklet e arsimit në UET.

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

1. Prof Asoc. Ilir Yzeiraj

2. Dr. Arben Muka